# MARRËVESHJE E PËRKOHSHME

# MBI TREGTINË DHE BASHKËPUNIMIN TREGTAR NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN NGA NJËRA ANË, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NGA ANA TJETËR

KOMUNITETI EUROPIAN,

referuar më poshtë si ‘Komuniteti’,

nga njëra anë, dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË,

referuar më poshtë si ‘Shqipëria’,

nga ana tjetër,

MEQË:

(1) Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe Shteteve të tyre Anëtare nga njëra anë, dhe Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar më Luksemburg më 12 qershor 2006.

(2) Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ka për qëllim vendosjen e lidhjeve të ngushta dhe të qëndrueshme bazuar në reciprocitet dhe interes të ndërsjellë, që duhet t'i japë mundësinë Shqipërisë të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet të vendosura më parë.

(3) Është i nevojshëm zhvillimi i lidhjeve tregtare nëpërmjet forcimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve të vendosura më parë, veçanërisht nëpërmjet Marrëveshjes mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik nënshkruar më 11 maj 1992, e cila hyri në fuqi më 4 dhjetor 1992.

(4) Për këtë qëllim, është e nevojshme të vihen në zbatim sa më shpejt të jetë e mundur, nëpërmjet Marrëveshjes së përkohshme, dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar.

(5) Disa dispozita të përfshira në Protokollin V të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për transportin tokësor, që kanë të bëjnë me trafikun rrugor tranzit, janë drejtpërdrejt të lidhura me lëvizjen e lirë të mallrave dhe rrjedhimisht janë përfshirë në këtë Marrëveshje të Përkohshme.

(6) Është e domosdoshme që deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe ngritjes së Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Përbashkët i krijuar në vijim Marrëveshjes mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik të ushtrojë plotfuqitë e ngarkuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit për Këshillin e Stabilizim-Asociimit dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes së Përkohshme,

BIEN DAKORD të përfundojnë Marrëveshjen dhe për këtë kanë emëruar si të plotfuqishmit e tyre:

KOMUNITETIN EUROPIAN

- [Presidenca që emëron përfaqësuesin]

- Olli REHN, Anëtar i Komisionit Europian

SHQIPËRINË

- [... për t'u emëruar ]

TË CILËT, pasi shkëmbyen plotfuqitë e gjetura në formën e duhur,

BIEN DAKORD SI VIJON:

## TITULLI 1

## PARIME TË PËRGJITHSHME

### NENI 1 (MSA neni 2)

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Europë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, shtetin e së drejtës si edhe parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.

### NENI 2 (MSA neni 7)

Marrëveshja duhet të përputhet plotësisht dhe zbatohet në përputhje me parashikimet përkatëse të OBT-së, në veçanti Nenin XXIV të GATT 1994.

## TITULLI II

## LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

### NENI 3 (MSA neni 16)

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimumi dhjetëvjeçare duke nisur nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me dispozitat e GATT 1994 dhe të OBT. Duke bërë këtë, ato marrin parasysh kërkesat specifike të parashtruara më poshtë.

2. Nomenklatura e Kombinuar e mallrave zbatohet për klasifikimin e mallrave në tregtinë ndërmjet të dyja Palëve.

3. Për çdo produkt, tarifa bazë mbi të cilin zbatohen reduktimet e njëpasnjëshme të vendosura në këtë Marrëveshje, është tarifa që zbatohet faktikisht *erga omnes* ditën para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

4. Tarifat e reduktuara që zbatohen nga Shqipëria të llogaritura ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshje, rrumbullakosen në numra të plotë duke përdorur parime aritmetike të zakonshme. Si rrjedhojë, të gjithë numrat që kanë 50 ose më pak presjes dhjetore, rrumbullakosen në zbritje të numrit të plotë më të afërt dhe të gjithë numrat që kanë më shumë se 50 pas presjes dhjetore, rrumbullakosen në ngjitje të numrit të plotë më të afërt.

5. Nëse, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, zbatohet ndonjë reduktim tarifor mbi bazën *erga omnes*, në veçanti reduktimet që rrjedhin prej negociatave për tarifat në OBT, tarifa të tilla të reduktuara zëvendësojnë tarifën bazë përmendur në paragrafin 3 që nga data kur zbatohen reduktime të tilla.

6. Komuniteti dhe Shqipëria do t'i komunikojnë njëri-tjetrit tarifat bazë përkatëse të tyre.

## KAPITULLI 1

## PRODUKTET INDUSTRIALE

### NENI 4 (MSA neni 17)

1. Dispozitat e këtij Kapitulli janë të aplikueshme për produktet që e kanë origjinën në Komunitet ose Shqipëri të renditura në Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombinuar, me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994).

2. Objekt i kësaj Marrëveshjeje nuk janë produktet e mbuluara nga Traktati Themelues i Komunitetit Europian të Energjisë.

### NENI 5 (MSA neni 18)

1. Detyrimet doganore për importet drejt Komunitetit të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kufizimet sasiore për importet drejt Komunitetit dhe masat me efekt të njëjtë me to për produktet që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

### NENI 6 (MSA neni 19)

1. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, përveç atyre të renditura në Shtojcën I, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë të mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, të cilat janë renditur në Shtojcën I, reduktohen në mënyrë progresive në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:

   – në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në 80% të detyrimit bazë

– më 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 60% të detyrimit bazë

– në 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 40% të detyrimit bazë

– në 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 20% të detyrimit bazë

– në 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 10% të detyrimit bazë

– në 1 janar të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimet e mbetura për importin shfuqizohen.

3. Kufizimet sasiore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet dhe masat me efekt të njëjtë me to, shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 7 (MSA neni 20)

Komuniteti dhe Shqipëria, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo detyrim që ka efekt të barabartë me detyrimet doganore për importet.

NENI 8 (MSA neni 21)

1. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë tarifat doganore për eksportet dhe tarifat me efekt të njëjtë me to.

2. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë ndërmjet tyre të gjitha kufizimet sasiore për eksportet dhe masat me efekt të njëjtë me to.

NENI 9 (MSA neni 22)

Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të reduktuar tarifat doganore në tregtinë me Komunitetin më shpejt se sa parashikohet në nenin 19, në rast se situata ekonomike e përgjithshme e saj dhe situata e sektorit ekonomik në fjalë e lejojnë këtë.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të analizojë situatën në këtë aspekt dhe do të japë rekomandimet e nevojshme.

NENI 10 (MSA neni 23)

Protokolli 1 parashtron rregullimet e zbatueshme për produktet e hekurit dhe çelikut të Kapitujve 72 dhe 73 të Nomenklaturës së Kombinuar.

## KAPITULLI II

## BUJQËSIA DHE PESHKIMI

### NENI 11 (MSA neni 24)

### Përkufizim

1. Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitet ose në Shqipëri..

2. Termi "produkte bujqësore dhe të peshkimit" u referohet produkteve të renditura në Kapitujt 1 deri 24 të Nomenklaturës së Kombinuar si dhe produkteve të renditura në Shtojcën I, §I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT, 1994).

3. Ky përkufizim përfshin peshkun dhe produktet e peshkimit të mbuluara nga kapitulli 3, titujt 1604 dhe 1605, dhe nëntitujt 0511 91, 2301 20 00 dhe 1902 20 10.

### NENI 12 (MSA neni 25)

Protokolli 2 parashtron rregullimet për tregtinë e produkteve bujqësore të përpunuara që renditen aty.

### NENI 13 (MSA neni 26)

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Komuniteti shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Shqipëri.

2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitet.

NENI 14 (MSA neni 27)

Produktet bujqësore

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti shfuqizon tarifat doganore dhe tarifat me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Shqipëri, përveç atyre të titujve Nos 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204 të Nomenklaturës së Kombinuar.

   Për produktet e trajtuara në Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilat Tarifa Doganore e Përbashkët parashikon zbatimin e tarifave doganore *ad valorem* dhe një tarifë doganore specifike, eliminimi zbatohet vetëm ndaj pjesës *ad valorem* të tarifës.

2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti zbaton hyrjen pa barra doganore për importet në Komunitet të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri dhe që përfshihen në titujt 1701 dhe 1702 të Nomenklaturës së Kombinuar, brenda kufirit të një kuote tarifore vjetore prej 1000 tonësh.

3. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Shqipëria:

   (a) shfuqizon detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (a);

   (b) redukton në mënyrë progresive detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në *Shtojcën II (b)* në përputhje me kalendarin e treguar për çdo produkt në atë shtojcë..

   (c) shfuqizon detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në *Shtojcën II (c)* brenda kufirit të kuotës tarifore të paraqitur për produktet në fjalë.

4. Protokolli 3 parashtron rregullimet që zbatohen për verërat dhe pijet alkoolike të përmendura.

5. Shqipëria përfiton nga sasia e plotë e kuotave të marrëveshjes gjatë pjesës së mbetur të vitit kalendarik në të cilin Marrëveshja e Përkohshme hyn në fuqi.

NENI 15 (MSA neni 28)

Produktet e peshkimit

1. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti heq të gjitha detyrimet doganore për importet e peshkut dhe të produkteve të peshkimit, përveç atyre të renditura në Shtojcën III që e kanë origjinën në Shqipëri. Produktet e renditura në Shtojcën III rregullohen nga dispozitat e paraqitura aty.

   Shqipëria përfiton nga sasia e plotë e kuotave të marrëveshjes gjatë pjesës së mbetur të vitit kalendarik në të cilin Marrëveshja e Përkohshme hyn në fuqi.

2. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria nuk zbaton detyrime të importit ose tarifa me efekt të njëjtë me to për peshkun dhe produktet e peshkimit që e kanë origjinën në Komunitetin Europian.

NENI 16 (MSA neni 29)

Komuniteti dhe Shqipëria, duke marrë parasysh vollimin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit ndërmjet Palëve, ndjeshmëritë e veçanta të tyre, rregullat e politikave të përbashkëta të Komunitetit dhe politikave të Shqipërisë për bujqësinë dhe peshkimin, rolin e bujqësisë dhe peshkimit në ekonominë e Shqipërisë, si dhe pasojat e negociatave shumëpalëshe për tregtinë në kuadër të OBT-së, do të shqyrtojnë në Këshillin e Stabilizim-Asociimit, jo më vonë se gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, produkt për produkt dhe mbi një bazë të ndërsjellë të rregullt dhe të përshtatshme, mundësitë për t'i bërë lëshime të mëtejshme njëri-tjetrit me qëllim zbatimin e një liberalizimi më të madh të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit.

NENI 17 (MSA neni 30)

Dispozitat e këtij Kapitulli nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në zbatimin në mënyrë të njëanshme të masave më favorizuese prej njërës apo tjetrës Palë.

NENI 18 (MSA neni 31)

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti nenet 25 dhe 30, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve të bujqësisë dhe peshkimit, në rast se importet e produkteve që e kanë origjinën në njërën nga të dyja Palët, të cilat u nënshtrohen lëshimeve të

dhëna sipas neneve 12, 14 dhe 15, shkaktojnë çrregullime serioze në tregjet ose mekanizmat rregullatorë të brendshëm në Palën tjetër, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Në pritje të kësaj zgjidhjeje, Pala përkatëse mund të marrë masat që ajo i quan të nevojshme.

KAPITULLI III

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

NENI 19 (MSA neni 32)

Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe këtu ose në Protokollet 1, 2 dhe 3.

NENI 20 (MSA neni 33)
Pezullimi

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to dhe as nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

3. Pa cënuar lëshimet e bëra në bazë të nenit 13 *(MSA 26)*, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk kufizojnë në asnjë lloj mënyre ushtrimin e politikave bujqësore përkatëse të Shqipërisë dhe Komunitetit, ose marrjen e masave në kuadër të atyre politikave për sa kohë që këto veprime nuk ndikojnë në regjimin e importeve në Shtojcat II dhe III.

NENI 21 (MSA neni 34)
Ndalimi i diskriminimit fiskal

1. Palët shmangin marrjen e masave ose shfuqizimin e praktikave me natyrë fiskale të brendshme ose ato ekzistuese që shkaktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi diskriminim ndërmjet produkteve të njërës Palë dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën në territorin e Palës tjetër.

2. Produktet e eksportuara në territorin e njërës nga Palët nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumën e tatimit të tërthortë të vendosur mbi to.

NENI 22 (MSA neni 35)

Dispozitat lidhur me shfuqizimin e tarifave doganore për importet zbatohen gjithashtu edhe për tarifat doganore me natyrë fiskale.

NENI 23 (MSA neni 36)

Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë, rregullimet ndërkufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon mbajtjen apo krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë apo rregullimet për tregtinë kufitare, përveçse në rastet kur ato ndryshojnë rregullimet tregtare të parashikuara nga kjo Marrëveshje.

2. Gjatë periudhave tranzitore të përcaktuara në nenin 6, kjo Marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e rregullimeve privilegjuese preferenciale specifike që rregullojnë lëvizjen e mallrave, qoftë të parashtruara në marrëveshjet kufitare të përfunduara më parë ndërmjet një ose më shumë Shtetesh Anëtare dhe Shqipërisë, ose që kanë rrjedhur prej marrëveshjeve dypalëshe të përcaktuara në Titullin III të përfunduara nga Shqipëria për të promovuar tregtinë rajonale.

3. Konsultimet ndërmjet Palëve zhvillohen në Këshillin e Stabilizim-Asociimit lidhur me marrëveshjet që përshkruhen në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe, sipas kërkesës, për çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me politikat e tyre përkatëse të tregtisë me vendet e treta. Veçanërisht në rastin e një vendi të tretë aderues në Komunitet, konsultime të tilla do të zhvillohen në mënyrë që të garantohet marrja parasysh e interesave të ndërsjella të Komunitetit dhe Shqipërisë të parashtruara në këtë Marrëveshje.

NENI 24 (MSA neni 37)

Dumpingu dhe Subvencioni

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk i pengon palët që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe nenin 25 *(MSA 38)*.

2. Nëse njëra nga Palët zbulon se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh *dumping* dhe/ose subvencionim kundërveprues, kjo palë mund të ndërmarrë masat e duhura ndaj kësaj praktike në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese dhe legjislacionin e saj të brendshëm lidhur me të.

NENI 25 (MSA neni 38)

Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse

1. Dispozitat e Nenit XIX GATT 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse zbatohen ndërmjet palëve.

2. Kur cilido produkt i njërës Palë që importohet në territorin e Palës tjetër në sasi të tilla dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë:

– dëme serioze ndaj industrisë vendase të produkteve të ngjashme ose që janë drejtpërsëdrejti konkurruese në territorin e Palës importuese; ose

– çrregullime serioze në cilindo sektor të ekonomisë apo vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike në një rajon të Palës importuese,

Pala importuese mund të marrë masat e përshtatshme sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë nen.

3. Masat mbrojtëse dypalëshe kundrejt importeve të Palës tjetër nuk duhet të kapërcejnë nivelin e nevojshëm për riparimin e vështirësive që kanë lindur dhe normalisht duhet të konsistojnë në pezullimin e reduktimit të mëtejshëm të çdo norme taifore tarifor të aplikueshëm të parashikuar në këtë Marrëveshje për produktin përkatës, ose në rritjen e çdo norme tarifore për atë produkt deri në një kufi maksimal që i korrespondon normës tarifore të statusit të Kombit Më Të Favorizuar të aplikueshme për të njëjtin produkt. Masa të tilla përmbajnë elementë të qartë që sjellin në mënyrë progresive eliminimin e tyre në fund të periudhës së vendosur, si afat përfundimtar, dhe nuk merren për një periudhë më të gjatë se një vit. Në rrethana shumë të jashtëzakonshme mund të merren masa maksimumi deri në një periudhë prej deri në tre vjet. Asnjë masë mbrojtëse dypalëshe nuk zbatohet për importin e një produkti që më parë i është nënshtruar një mase të tillë për një periudhë të paktën prej tre vjetësh që nga skadimi i masës.

4. Në rastet e përcaktuara në këtë nen, përpara marrjes së masave të parashikuara në të, ose në rastet kur aplikohet paragrafi 5 (b) i këtij neni, sapo të jetë e mundur, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin e përshtatshëm, për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.

5. Për zbatimin e paragrafëve të mësipërm aplikohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Vështirësitë që lindin nga situata e përmendur në këtë nen i kalohen për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili mund të marrë çfarëdolloj vendimi të nevojshëm për t'i dhënë fund këtyre vështirësive.

Në rast se Këshilli i Stabilizim-Asociimit ose Pala eksportuese, brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asociimit, nuk ka marrë një vendim për t'i dhënë fund këtyre vështirësive, ose kur nuk është arritur ndonjë zgjidhje tjetër e kënaqshme, Pala importuese mund të miratojë masat e duhura për të zgjidhur problemin në përputhje me këtë nen. Në përzgjedhjen e masave mbrojtëse u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negative në funksionimin e rregullimeve të vendosura në këtë Marrëveshje. Masat mbrojtëse të zbatuara në përputhje me Nenin XIX GATT dhe Marrëveshjen e OBT-së për Masat Mbrojtëse ruajnë nivelin/hapësirën e preferencave të ofruara në këtë Marrëveshje.

(b) Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informacionin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Pala përkatëse, në situatat e përcaktuara në këtë nen, mund të aplikojë menjëherë masa të përkohshme të nevojshme për të trajtuar situatën dhe informon njëherësh Palën tjetër për këtë.

Masat mbrojtëse i njoftohen menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe u nënshtrohen konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti me qëllim për të përcaktuar një kalendar veprimesh për heqjen e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

6. Në rast se Komuniteti ose Shqipëria ia nënshtron importet e produkteve që rrezikojnë të shkaktojnë vështirësitë e përmendura në këtë nen, një procedure administrative që ka për qëllim sigurimin e shpejtë të informacionit për tendencën e rrjedhave tregtare, informon Palën tjetër.

NENI 26 (MSA neni 39)

Klauzola e pamjaftueshmërisë

1. Kur pajtueshmëria me dispozitat e këtij Titulli sjell:

(a) një pamjaftueshmëri serioze, ose një rrezik për pamjaftueshmëri, të artikujve ushqimorë ose produkteve të tjerë thelbësorë për Palën eksportuese; ose

(b) rieksportimin në një vend të tretë të një produkti ndaj të cilit Pala eksportuese ruan kufizime sasiore për eksportin, tarifa për eksportin, ose masa me efekt të njëjtë me to, dhe kur situatat e përmendura më sipër shkaktojnë, ose mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha për Palën eksportuese

kjo Palë mund të marrë masat e duhura në përputhje me kushtet dhe me procedurat vendosura në këtë nen.

2. Në përzgjedhjen e masave u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negativisht në funksionimin e rregullimeve të kësaj Marrëveshjeje. Këto masa zbatohen në mënyrë të tillë që nuk përbëjnë diskriminim arbitrar e të pajustifikueshëm kur mbizotërojnë të njëjtat kushte, ose një kufizim të maskuar në tregti, dhe eliminohen kur kushtet nuk e justifikojnë më mbajtjen e tyre.

3. Përpara marrjes së masave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni ose, sapo të jetë e mundur, në rastet kur zbatohet paragrafi 4 i këtij neni, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, do t'i japin Këshillit të Stabilizim-Asociimit të gjithë informacionin përkatës, me qëllim për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme përnga Palët. Palët, brenda Këshillit të Stabilizim-Asociimit, mund të bien dakord për mjetet e nevojshme për t'i dhënë fund vështirësive. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Pala eksportuese mund të zbatojë masat e përmendura në këtë nen për eksportimin e produktit në fjalë.

4. Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informimin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Komuniteti ose Shqipëria cilado qoftë e interesuar, mund të zbatojnë sa më parë masa parandaluese të nevojshme për të trajtuar situatën dhe informojnë Palën tjetër menjëherë për këtë.

5. Çdo masë e zbatuar sipas këtij neni i njoftohet menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asociimit dhe i nënshtrohet konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti për të përcaktuar një kalendar veprimesh për heqjen e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

NENI 27 (MSA neni 40)

Monopolet shtetërore

Shqipëria do të përshtatë në mënyrë progresive të gjitha monopolet shtetërore me karakter tregtar për të siguruar që nga fundi i vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të mos ekzistojnë diskriminime ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë lidhur me kushtet sipas të cilave sigurohen dhe tregtohen mallrat. Këshilli i Stabilizim-Asociimit informohet për masat e miratuara për arritjen e këtij objektivi.

NENI 28 (MSA neni 41)

Përveçse rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje, Protokolli 4 parashtron rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

NENI 29 (MSA neni 42)

Kufizimet e autorizuara

Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave tranzit të justifikuara në bazë të moralit publik, politikave publike, ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet Palëve.

NENI 30 (MSA neni 43)

1. Palët bien dakord që bashkëpunimi administrativ është i domosdoshëm për zbatimin dhe kontrollin e trajtimit të privilegjuar të dhënë sipas këtij Titulli dhe nënvizojnë angazhimin e tyre për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në dogana dhe çështje që lidhen me to.

2. Kur njëra Palë, në bazë të informacionit objektiv, ka konstatuar mungesën e bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsi apo mashtrim sipas këtij Titulli, Pala e prekur mund të

pezullojë përkohësisht trajtimin privilegjues të produktit/produkteve përkatëse në përputhje me këtë nen.

3. Për qëllimet e këtij neni, mungesa e bashkëpunimit administrativ do të thotë përveç të tjerash:

a) mosrespektim i përsëritur i detyrimeve për të verifikuar statusin e origjinës së produktit/produkteve përkatës;

b) refuzim i përsëritur ose vonesa e panevojshme për të kryer dhe/ose komunikuar rezultatet e një verifikimi pasues të vërtetësisë së origjinës;

c) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme në marrjen e autorizimit për kryerjen e misioneve të bashkëpunimit administrativ për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve ose saktësinë e informacionit të nevojshëm për dhënien e trajtimit preferencial në fjalë.

Për qëllimet e këtij neni, konstatimi i parregullsive ose mashtrimit mund të bëhet, përveç të tjerash, kur ka një rritje të shpejtë, pa ndonjë shpjegim të kënaqshëm, të importeve të mallrave, që tejkalon nivelin e zakonshëm të prodhimit dhe kapacitetin eksportues të Palës tjetër, dhe që lidhet me informacionet objektive që kanë të bëjnë me parregullsitë ose mashtrimet.

4. Zbatimi i pezullimit të përkohshëm u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) Pala që ka bërë një konstatim, mbi bazën e informacionit objektiv, të mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsive ose mashtrimit, njofton pa vonesa të panevojshme Komitetin e Stabilizim-Asociimit për konstatimin e saj, së bashku me informacionin objektiv dhe fillon konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në bazë të gjithë informacioneve të nevojshme dhe konstatimeve objektive, me synim arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja Palët.

b) Në rast se Palët kanë filluar konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit si më sipër dhe kanë dështuar të bien dakord për një zgjidhje të pranueshme brenda tri muajsh pas njoftimit, Pala e interesuar mund të pezullojë përkohësisht trajtimin preferencial përkatës të produktit/produkteve përkatëse. Pezullimi i përkohshëm i njoftohet Komitetit të Stabilizim-Asociimit pa vonesa të tepruara.

c) Pezullimet e përkohshme në bazë të këtij neni kufizohen deri në atë masë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Palës së interesuar. Ato nuk zgjasin për më shumë se gjashtë muaj, periudhë e cila mund të rinovohet. Pezullimet e përkohshme i njoftohen

Komitetit të Stabilizim-Asociimit menjëherë pas miratimit të tyre. Ato u nënshtrohen konsultimeve periodike pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, veçanërisht me synimin për t'i përfunduar ato sapo të mos ketë më kushte për zbatimin e këtyre pezullimeve.

5. Njëkohësisht me njoftimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit sipas paragrafit 4a) të këtij neni, Pala e interesuar duhet të publikojë një njoftim për importuesit në Fletoren e saj Zyrtare. Njoftimi për importuesit duhet të tregojë se në bazë të informacionit objektiv për produktin përkatës, është bërë një konstatim i mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose i parregullsive ose mashtrimeve.

NENI 31 (MSA neni 44 )

Në rast gabimi të bërë nga autoritetet kompetente gjatë menaxhimit të duhur të sistemit privilegjues të eksportit dhe në veçanti gjatë zbatimi të dispozitave të protokollit të kësaj marrëveshjeje në lidhje me përkufizimin e origjinës së produkteve dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, kur ky gabim çon në pasoja lidhur me tarifat e importit, pala kontraktuese që përballet me këto pasoja mund t'i kërkojë Këshillit të Stabilizim-Asociimit shqyrtimin e mundësive për miratimin e të gjitha masave të duhura që synojnë zgjidhjen e situatës.

NENI 32 (MSA neni 45)

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje të bëhet pa cënuar aplikimin e dispozitave të së drejtës Komunitare për Ishujt Kanarie.

## TITULLI III

### DISPOZITA TË TJERA PËR TREGTINË DHE BASHKËPUNIMIN TRGETAR

NENI 33 (MSA neni 59.1)

Trafiku tranzit

Përkufizime (Protokolli 5 MSA, neni 3a) dhe b))

1. Për qëllime të këtij Protokolli, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

   a) Trafik i tranzitit të Komunitetit: transporti, nga një transportues i vendosur në Komunitet, i mallrave në tranzit nëpërmjet territorit shqiptar në rrugën drejt ose nga një Shtet Anëtar i Komunitetit;

   b) Trafiku i tranzitit shqiptar: transporti, nga një transportues i vendosur në Shqipëri, i mallrave në tranzit nga Shqipëria nëpërmjet territorit të Komunitetit dhe të destinuara për një vend të tretë, ose i mallrave nga një vend i tretë të destinuara për Shqipërinë.

Dispozita të Përgjithshme (Protokolli 5 MSA, neni 11.2, 3. dhe 5)

2. Palët bien dakord që t'i japin akses të pakufizuar trafikut të tranzitit të Komunitetit përmes Shqipërisë dhe në trafikun e tranzitit shqiptar përmes Komunitetit me efekt nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Nëse, si rezultat i të drejtave të dhëna sipas paragrafit 2, trafiku i tranzitit nga transportuesit e Komunitetit rritet në një shkallë të tillë që shkakton ose rrezikon shkaktimin e dëmit serioz në akset e përmendura në nenin 5 të Protokollit nr. 5 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për Transportin Tokësor dhe në të njëjtat rrethana, lindin probleme në territorin e Komunitetit afër kufijve shqiptarë, çështja do të paraqitet në Komisionin e Përbashkët në përputhje me nenin 44 të kësaj Marrëveshje. Palët mund të propozojnë masa përkohësisht të jashtëzakonshme, jodiskriminuese, sipas nevojës, për të kufizuar ose lehtësuar këtë dëm.

4. Palët do të frenohen nga marrja e masave njëpalëshe që mund të çojnë në diskriminim midis ngarkesave ose automjeteve të Komunitetit dhe Shqipërisë. Çdo Palë

Kontraktuese do të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të lehtësuar transportin rrugor drejt ose përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

Thjeshtimi i formaliteteve (Protokolli 5 MSA, neni 19.1 dhe 3)

5. Palët bien dakord që të thjeshtojnë lëvizjen e mallrave nëpërmjet hekurudhave dhe rrugëve, qoftë bilateral ose me tranzit.

6. Palët bien dakord, në shkallën e nevojshme, të ndërmarrin masa të përbashkëta dhe të nxisin miratimin e masave të mëtejshme thjeshtuese.

Zbatimi (Protokolli 5 MSA, neni 21.1 dhe 2 d))

7. Bashkëpunimi midis Palëve do të kryhet brenda kuadrit të Komisionit të Përbashkët në përputhje me nenin 44 të kësaj Marrëveshjeje. Ai veçanërisht do të koordinojë monitorimin, parashikimet dhe punët e tjera statistikore që kanë lidhje me transportin ndërkombëtar dhe trafikun tranzit në veçanti.

NENI 34 (MSA neni 60)

Palët angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirisht, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë në përputhje me dispozitat e Nenit VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

NENI 35 (MSA neni 67)

1. Palët përpiqen, kurdo të jetë e mundur, të shmangin vendosjen e masave kufizuese, përfshirë masat për kufizimin e importeve, për të mbrojtur bilancin e pagesave. Pala e cila miraton masa të tilla duhet t'i paraqesë sa më shpejt të jetë e mundur Palës tjetër një kalendar për heqjen e tyre.

2. Në rastin kur një ose më shumë Shtete Anëtare apo Shqipëria gjenden në një situatë tejet të vështirë të bilancit të pagesave, ose pranw njw rreziku tw afwrt, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, në përputhje me kushtet e vendosura nga Marrëveshja e OBT-së, mund të miratojë masa kufizuese, përfshirë masa mbi importet, të cilat duhet të jenë pwr njw kohw tw kufizuar dhe nuk mund të tejkalojnë masat veçanërisht të nevojshme për rregullimin e situatës së bilancit të pagesave. Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, informon menjëherë Palën tjetër.

3. Asnjë masë kufizuese nuk zbatohet për transfertat lidhur me investimet dhe sidomos lidhur me riatdhesimin e shumave të investuara ose të riinvestuara apo çdo lloj të ardhurash që rrjedhin nga to.

NENI 36 (MSA neni 69)

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cënojnë zbatimin, prej secilës Palë, të masave të nevojshme për të parandaluar shmangien e masave lidhur me aksesin e vendeve të treta në tregun e tyre nëpërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshje.

NENI 37 (MSA neni 71)

Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Dispozitat në vijim nuk përputhen me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:

(i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;

(ii) abuzimi me pozicionin dominues, nga një ose më shumë sipërmarrje, në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;

(iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara.

2. Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve interpretues të adoptuara nga institucionet e Komunitetit.

3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij Neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.

4. Shqipëria do të ngrejë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë veç të tjerash, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grante ndihme individuale në përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.

5. Secila prej Palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke i paraqitur, veç të tjerash Palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të Komunitet për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njërës Palë, Pala tjetër do t'i japë informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.

6. Shqipëria harton një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4, dhe i drejton këto skema ndihme në përputhje me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

7. (a) Me qëllim zbatimin e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se ajo konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian.

(b) Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas, autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane vlerëson bashkërisht kriteret për pranueshmërinë e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartohet harta rajonale e ndihmave në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

8. Në lidhje me produktet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:

- paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;
- çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kritereve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian dhe instrumenteve specifikë të Komunitetit të adoptuar mbi këtë bazë.

9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas konsultimeve të bëra me Këshillin e Stabilizim-Asociimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për konsultim.

Asgjë në këtë nen nuk cënon ose ndikon në ndonjë mënyrë për marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose të masave kundëvepruese në përputhje me nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

NENI 38 (MSA neni 72)

Brenda vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria zbaton, për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Europian, duke iu referuar veçanërisht nenit 86.

Të drejtat e veçanta të sipërmarrjeve publike gjatë periudhës tranzitore nuk përfshijnë mundësinë e vendosjes së kufizimeve sasiore, ose masave me efekt të njëjtë, mbi importet nga Komuniteti në Shqipëri.

NENI 39 (MSA neni 73)
Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare

1. Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

2. Shqipëria merr masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.

3. Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.

4. Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

NENI 40 (MSA neni 74)

Kontratat publike

1. Palët konsiderojnë si një objektiv të dëshirueshëm liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mos-diskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së.

2. Kompanive shqiptare, edhe nëse nuk janë vendosur në Komunitet, u jepet e drejta për të marrë pjesë për akordim kontrate në Komunitet sipas rregullave të prokurimit të Komunitetit, duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive komunitare, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Dispozitat e mësipërme zbatohen gjithashtu në kontratat e shërbimeve publike, sapo qeveria shqiptare të ketë miratuar legjislacionin duke vendosur rregullat komunitare për këtë fushë. Komuniteti shqyrton periodikisht nëse Shqipëria ka miratuar vërtetë këtë legjislacion.

3. Kompanitë komunitare që nuk janë vendosur në Shqipëri gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në bazë të Ligjit shqiptar për Prokurimin Publik duke mos marrë një trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë shoqërive shqiptare, jo më vonë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

4. Këshilli i Stabilizim-Asociimit shqyrton periodikisht mundësinë që Shqipëria të nisë lejimin për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës në Shqipëri të gjitha kompanive komunitare.
Shoqëritë komunitare të vendosura në Shqipëri sipas dispozitave të Kapitullit II të Titullit V, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive shqiptare.

NENI 41 (MSA neni 97)

Doganat

1. Palët do të vendosin një bashkëpunim në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor shqiptar me atë të Komunitetit, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar për doganat me atë të *acquis*.

2. Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushat e doganave.

3. Protokolli 5 vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganave.

## TITULLI IV

## DISPOZITAT INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

### NENI 42

Komiteti i Përbashkët i ngritur sipas Marrëveshjes midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik dhe e nënshkruar më 11 maj 1992, do të ushtrojë kompetencat dhe do të përmbushë detyrat që kjo Marrëveshje ia ngarkon Këshillit të Stabilizim-Asociimit ose Komitetit të Stabilizim-Asociimit.

Sipas dispozitave të nenit 43, Komiteti i Përbashkët do të veprojë në përputhje me të njëjtat modalitete që janë praktikuar deri tani në objektin e Marrëveshjes për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.

### NENI 43 (MSA neni 117 dhe 118)

Këshilli i Stabilizim Asociimit, me qëllim arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, ka kompetencën për të marrë vendime brenda objektit të Marrëveshjes, për çështjet e parashikuara në të. Vendimet e marra janë detyruese për Palët, të cilat do të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra.

Komiteti i Përbashkët mund të bëjë rekomandimet përkatëse. Ai harton vendimet dhe rekomandimet e tij me marrëveshje mes Palëve.

Komiteti i Përbashkët e vendos vetë rregulloren e brendshme të tij. Komiteti i Përbashkët do të mblidhet rregullisht me intervale kohore, sipas nevojës së rrethanave. Komiteti i Përbashkët do të drejtohet me radhë nga secila Palë. Kur është e mundur, Komiteti i Përbashkët do të bjerë dakord paraprakisht për agjendën e vet.

### NENI 44 (MSA neni 119)

Palët do t'i paraqesin Këshillit të Stabilizim Asociimit çdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund ta zgjidhë mosmarrëveshjen nëpërmjet një vendimi detyrues.

NENI 45 (MSA neni 123)

Brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë merr përsipër t'u sigurojë personave fizikë dhe juridikë të Palës tjetër, pa i diskriminuar në krahasim me shtetasit e vet, të drejtën për të mbrojtur të drejtat individuale dhe të drejtat e tyre të pronës tek organet kompetente gjyqësore dhe administrative të secilës prej Palëve..

NENI 46 (MSA neni 124)

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Palë të marrë masa:

a) të cilat ajo i konsideron të nevojshme për të parandaluar publikimin e informacionit në kundërshtim me interesat thelbësorë të sigurisë;

b) të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve ose materialeve luftarake, ose me kërkimin shkencor, zhvillimin ose prodhimin e domosdoshëm për çështjet e mbrojtjes, me kusht që këto masa të mos dëmtojnë kushtet e konkurrencës në lidhje me produktet që nuk destinohen për qëllime specifike ushtarake;

c) të cilat ajo i konsideron thelbësore për sigurinë e saj, në rastin e trazirave serioze të brendshme që cënojnë ruajtjen e rendit dhe të ligjeve, në kohë lufte ose tensioni ndërkombëtar serioz që përbën një kërcënim lufte, ose me qëllim që të përmbushë detyrimet që ka pranuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

NENI 47 (MSA neni 125)

1 Në fushat që mbulon kjo Marrëveshje dhe pa cënuar asnjë dispozitë të veçantë të saj:

– Rregullimet e zbatuara nga Shqipëria në lidhje me Komunitetin nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes Shteteve Anëtare, qytetarëve të tyre, kompanive ose firmave;

– Rregullimet e zbatuara nga Komuniteti në lidhje me Shqipërinë nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes qytetarëve, kompanive dhe firmave shqiptare.

2 Dispozitat e paragrafit 1 nuk cënojnë të drejtën e Palëve për të zbatuar dispozitat përkatëse të legjislacionit të tyre fiskal për taksapaguesit, të cilët nuk gjenden në të njëjtën situatë për sa i përket vendbanimit të tyre.

NENI 49 (MSA neni 15)

Bashkëpunimi me vendet kandidate për aderim në BE

1. Shqipëria mund të nxisë bashkëpunimin dhe të përfundojë një konventë për bashkëpunimin rajonal me cilindo vend kandidat për aderim në BE në secilën nga fushat e bashkëpunimit të mbuluara nga kjo Marrëveshje. Një konventë e tillë duhet të synojë që të sjellë gradualisht marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe këtij vendi në një linjë me pjesën përkatëse të Komunitetit Europian e Shteteve Anëtare të tij dhe vendit në fjalë

2. Shqipëria do të fillojë negociatat me Turqinë me synimin për të përfunduar, në mënyrë njëlloj frytdhënëse, një marrëveshje që vendos një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve në përputhje me Nenin XXIV të GATT.

Këto negociata duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, me synimin për të përfunduar marrëveshjen e sipërpërmendur përpara fundit të periudhës tranzitore të përmendur në nenin 3 (1).

NENI 50 (MSA neni 126)

1. Palët do të marrin të gjitha masat specifike ose të përgjithshme që duhen për të përmbushur detyrimet e dala nga kjo Marrëveshje. Ato do të kujdesen që objektivat e parashikuara në këtë Marrëveshje të përmbushen.

2. Nëse një nga Palët mendon se Pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e një prej detyrimeve të kësaj Marrëveshje, ajo mund të marrë masat e duhura. Para se të veprojë në këtë mënyrë, me përjashtim të rasteve tepër urgjente, ajo i paraqet Këshillit të Stabilizim Asociimit një material me informacionin përkatës për një ekzaminim të plotë të situatës, me synim kërkimin e një zgjidhjeje të pranueshme për Palët.

3. Gjatë përzgjedhjes së masave, përparësi u jepet detyrimisht atyre që cënojnë më pak funksionimin e kësaj Marrëveshje. Këto masa i bëhen të ditura menjëherë Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe bëhen objekt konsultimesh në Këshillin e Stabilizim Asociimit, nëse këtë e kërkon Pala tjetër.

NENI 50 (MSA neni 127)

Palët bien dakord që të konsultohen, sa më shpejt që të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve përkatëse, me kërkesë të njërës prej Palëve, për të diskutuar çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe aspekte të tjera relevante të marrëdhënieve ndërmjet Palëve.

Dispozitat e këtij Neni nuk ndikojnë aspak dhe nuk cënojnë Nenet 31, 37, 38, 39 dhe 43.

NENI 51(MSA neni 129)

Protokollet 1, 2, 3, 4 dhe 6 dhe Shtojca I deri në III dhe Shtojca V, përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje

Referimi i shtojcave dhe protokolleve për nenet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit duhet të lexohen si referuese të neneve të Marrëveshjes së Përkohshme siç tregohet në titujt e neneve të Marrëveshjes aktuale.

NENI 52

Kjo Marrëveshje ka efekt deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që do të nënshkruhet në Luksemburg më 12 qershor 2006.

Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

NENI 53 (MSA neni 132)

Kjo Marrëveshje zbatohet në territoret ku zbatohen Traktatet themeluese të Komunitetit Evropian dhe të Komunitetit Evropian për Energjinë Atomike sipas kushteve të parashikuara në këto Traktate, nga njëra anë,dhe në territorin e Shqipërisë, nga ana tjetër.

NENI 54 (MSA neni 133)

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë visari i Marrëveshjes.

NENI 55(MSA neni 134)

Kjo Marrëveshje hartohet në duplikatë në të gjitha gjuhët zyrtare të Palëve në tekste njëlloj autentike.

NENI 56 (MSA neni 135)

Palët e ratifikojnë ose miratojnë këtë Marrëveshje në bazë të procedurave të veta.

Instrumentet e ratifikimit dhe miratimit depozitohen tek Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Europian. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës se depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose miratimit.

Nga hyrja e saj në fuqi, nenet 3 deri 14 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtar midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Shqipërisë nënshkruar më 11 maj 1992, do të pushojnë efektet.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca I - Koncesione Tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të Komunitetit

Shtojca II (a) - Tarifat koncensionare shqiptare për prodhimet primare bujqesore të prodhuara ne komunitet (referuar Nenit 27(3)(a))

| Τοπικός Οίνος | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI* | *Greqisht* |
| Μοναστήρι (Monastiri) | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë tavoline me GI* | *Greqisht* |
| Κτήμα (Ktima) | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë tavoline me GI* | *Greqisht* |

| LUKSEMBURGU | | | |
|---|---|---|---|
| Marque nationale | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri psr* | *Frëngjisht* |
| Appellation contrôlée | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri psr* | *Frëngjisht* |
| Appellation d'origine controlée | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri* | *Frëngjisht* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | *psr* | |
| Vin de pays | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI* | *Frëngjisht* |
| Grand premier cru | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Frëngjisht* |
| Premier cru | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Frëngjisht* |
| Vin classé | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Frëngjisht* |
| Château | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri psr* | *Frëngjisht* |

| HUNGARIA | | | |
|---|---|---|---|
| minőségi bor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| különleges minőségű bor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| fordítás | *Tokaj / -i* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| máslás | *Tokaj / -i* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| szamorodni | *Tokaj / -i* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| aszú … puttonyos, *completed by numbers 3-6* | *Tokaj / -i* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| aszúeszencia | *Tokaj / -i* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| eszencia | *Tokaj / -i* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| tájbor | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI* | *Hungarisht* |
| bikavér | *Eger, Szekszárd* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| késői szüretelésű bor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| válogatott szüretelésű bor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| muzeális bor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |
| siller | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Hungarisht* |

| AUSTRIA | | | |
|---|---|---|---|
| Qualitätswein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Qualitätswein besonderer Reife und Leseart / Prädikatswein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Qualitätswein mit staatlicher Prüfnummer | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Ausbruch / Ausbruchwein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Auslese / Auslesewein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Beerenauslese (wein) | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Eiswein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Kabinett / Kabinettwein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Schilfwein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Spätlese / Spätlesewein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Strohwein | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Trockenbeerenauslese | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Landwein | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI* | |
| Ausstich | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Auswahl | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Bergwein | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Klassik / Classic | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Erste Wahl | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Hausmarke | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Heuriger | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Jubiläumswein | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Reserve | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Schilcher | *Steiermark* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore psr* | *Gjermanisht* |
| Sturm | *Të gjitha* | *Musht rrushi pjeserisht i fermentuar me GI* | *Gjermanisht* |

| PORTUGALIA | | | |
|---|---|---|---|
| Denominação de origem (DO) | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë* | *Portugalisht* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | *cilësore likeri psr, Verë cilësore gjyzem e gazuar psr, Verë cilësore me gaz psr* | |
| Denominação de origem controlada (DOC) | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri psr, Verë cilësore gjyzem e gazuar psr, Verë cilësore me gaz psr* | *Portugalisht* |
| Indicação de proveniencia regulamentada (IPR) | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri psr, Verë cilësore gjyzem e gazuar psr, Verë cilësore me gaz psr* | *Portugalisht* |
| Vinho doce natural | *Të gjitha* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Vinho generoso | *DO Porto, Madeira, Moscatel de Setúbal, Carcavelos* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Vinho rajon të caktuaral | *Të gjitha* | *Verë tavoline me GI* | *Portugalisht* |
| Canteiro | *DO Madeira* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Colheita Seleccionada | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë tavoline me GI* | *Portugalisht* |
| Crusted / Crusting | *DO Porto* | *Verë cilësore likeri psr* | *Anglisht* |
| Escolha | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë tavoline me GI* | *Portugalisht* |
| Escuro | *DO Madeira* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Fino | *DO Porto*<br><br>*DO Madeira* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Frasqueira | *DO Madeira* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Garrafeira | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë tavoline me GI, Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Lágrima | *DO Porto* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Leve | *Table wine with GI Estremadura and Ribatejano*<br><br>*DO Madeira, DO Porto* | *Verë tavoline me GI, Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Nobre | *DO Dão* | *Verë cilësore psr* | *Portugalisht* |
| Reserva | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr, Verë cilësore likeri psr, Verë cilësore me gaz psr, Verë tavoline me GI* | *Portugalisht* |
| Reserva velha (or grande reserva) | *DO Madeira* | *Verë cilësore me gaz psr, Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Ruby | *DO Porto* | *Verë cilësore likeri psr* | *Anglisht* |
| Solera | *DO Madeira* | *Verë cilësore likeri psr* | *Portugalisht* |
| Super reserva | *Të gjitha* | *Verë cilësore me gaz psr* | *Portugalisht* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Superior | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr,*<br>*Verë cilësore likeri psr,*<br>*Verë tavoline me GI* | *Portugalisht* |
| Tawny | *DO Porto* | *Verë cilësore likeri psr* | *Anglisht* |
| Vintage supplemented by Late Bottle (LBV) ou Character | *DO Porto* | *Verë cilësore likeri psr* | *Anglisht* |
| Vintage | *DO Porto* | *Verë cilësore likeri psr* | *Anglisht* |

| SLLOVENIA | | | |
|---|---|---|---|
| Penina | *Të gjitha* | *Verë cilësore me gaz psr* | *Sllovenisht* |
| pozna trgatev | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| izbor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| jagodni izbor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| suhi jagodni izbor | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| ledeno vino | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| arhivsko vino | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| mlado vino | *Të gjitha* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| Cviček | *Dolenjska* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |
| Teran | *Kras* | *Verë cilësore psr* | *Sllovenisht* |

| SLLOVAKIA | | | |
|---|---|---|---|
| forditáš | *Tokaj / -ská / -ský / -ské* | *Verë cilësore psr* | *Sllovakisht* |
| mášláš | *Tokaj / -ská / -ský / -ské* | *Verë cilësore psr* | *Sllovakisht* |
| samorodné | *Tokaj / -ská / -ský / -ské* | *Verë cilësore psr* | *Sllovakisht* |
| výber … putňový, *completed by numbers 3-6* | *Tokaj / -ská / -ský / -ské* | *Verë cilësore psr* | *Sllovakisht* |
| výberová esencia | *Tokaj / -ská / -ský / -ské* | *Verë cilësore psr* | *Sllovakisht* |
| esencia | *Tokaj / -ská / -ský / -ské* | *Verë cilësore psr* | *Sllovakisht* |

SHTOJCA III

LISTA E PIKAVE TË KONTAKTIT

(siç përmendet në nenin 12 të Shtojcës II të Protokollit 3)

(a) Shqipëria

Znj. Brunilda Stamo, Drejtoreshë

Drejtoria e Politikave të Prodhimit

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së konsumatorit

Sheshi Skenderbej Nr. 2

Tirana

Albania

Telephone/fax: +355 4 22 58 72

Email: bstamo@albnet.net

(b) Komuniteti

European Commission

Dirtectorate-General for Agriculture and Rural Development

Directorate B International Affairs II

Head of Unit B.2 Enlargement

B-1049 Bruxelles / Brussel

Belgium

Telephone: +32 2 299 11 11

Fax: +32 2 296 62 92

# PROTOKOLLI 4

# PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT "PRODUKTE ORIGJINUESE" DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

<u>(MSA PROTOKOLL 4)</u>

PASQYRA E LËNDËS

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

- Neni 1 Përkufizime

TITULLI II PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT "Produkte Origjinuese"

- Neni 2 Kërkesa të përgjithëshme
- Neni 3 Kumulimet dypalëshe ne Komunitet
- Neni 4 Kumulimi dypalesh ne Shqiperi
- Neni 5 Produktet tërësisht të përfituara
- Neni 6 Produkte të punuara mjaftueshëm ose të përpunuara
- Neni 7 Punime ose operacione të pamjaftueshme
- Neni 8 Njësia e kualifikimit
- Neni 9 Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentat
- Neni 10 Setet, kompletet
- Neni 11 Elementët neutrale

TITULLI III KËRKESAT TERITORIALE

- Neni 12 Parimet e territorialitetit
- Neni 13 Transporti direkt
- Neni 14 Ekspozitat

TITULLI IV TËRHEQJA OSE PËRJASHTIMI

- Neni 15 Ndalimi i tërheqjes prej, ose përjashtimeve nga, tarifat doganore

TITULLI V VËRTETIMI I ORIGJINËS

- Neni 16 Kërkesa të përgjithëshme
- Neni 17 Procedurat për lëshimin e çertifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1
- Neni 18 Çertifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar aposteriori
- Neni 19 Lëshimi i dublikates të çertifikatës të qarkullimit të mallrave EUR.1
- Neni 20 Lëshimi i çertifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 mbi bazën e vërtetimit të origjinës të lëshuar apo bërë më parë
- Neni 21 Kushtet për prodhimin e një deklarate fature
- Neni 22 Eksportuesi i aprovuar
- Neni 23 Vlefshmëria e deklaratës së origjinës
- Neni 24 Depozitimi i deklaratës së origjinës
- Neni 25 Importimet me dergesë të parë
- Neni 26 Përjashtimet nga deklarata e origjinës
- Neni 27 Dokumentat mbështetese
- Neni 28 Ruajtja e deklaratës së origjinës dhe e dokumentave mbështetëse
- Neni 29 Mospërputhjet dhe gabimet formale
- Neni 30 Shumat e shprehura ne Euro

TITULLI VI RREGULLIMET PËR BASHKËPUNIM ADMINISTRATIV

- Neni 31 Asistenca e përbashkët
- Neni 32 Verifikimi i vërtetësive të origjinës
- Neni33 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
- Neni 34 Penalitetet
- Neni 35 Zonat e lira

TITULLI VII CEUTA DHE MELILLA

- Neni 36 Zbatueshmeria e protokollit
- Neni 37 Kushtet specifike

TITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- Neni 38 Amendamentet e Protokollit

TITULLI I

DISPOZITA TE PËRGJITHËSHME

NENI 1

Përkufizimet

Për qëllime të këtij protokolli:

a) “prodhim” do të thotë çdo lloj punimi ose proçesi duke përfshirë operacione bashkimi ose specifike;

b) "material" do të thotë çdo lloj përbërësi, lëndë e parë, përbërës ose pjesë, etj., të përdorura në prodhimin e produktit;

c) "produkt" do të thotë produkti që është përpunuar, edhe nëse ai është për tu përdorur më vonë në një proces tjetër prodhimi;

d) "mallra" përfshin së bashku, materialet dhe produktet;

e) "vlera doganore" do të thotë vlera e përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen mbi Zbatimin e Nenit VII te Marrëveshjes së Përgjithëshme mbi Tarifat dhe Tregtinë GATT 1994 (Marrëveshja e OBT-së mbi Vlerësimin Doganor);

f) "çmimi ex-work" do të thotë çmimi i paguar për produktin ex-work tek prodhuesit e produktit në Komunitet ose në Shqipëri në të cilët ndërmerret proçesi apo puna përfundimtare, që siguron çmimin që përfshin vlerën e të gjithë materialeve të përdorura, minus taksat e brëndëshme të cilat janë, ose mund të jenë ripaguar kur produkti i përftuar eksportohet;

g) "vlera e materialeve" do të thotë vlera doganore në kohën e importimit të materialeve të përdorura jo origjinuese, ose, nëse kjo nuk është e njohur dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i përcaktuar i paguar për materialet në Komunitet dhe Shqipëri;

h) "vlera e materialeve origjinuese” do të thotë vlera e materialeve të tilla sic është përcaktuar në nënparagrafin (g) të aplikuara *mutatis mutandis*;

i) "vlera shtesë" merret nga çmimi ex-work minus vlerën doganore të seicilit nga materialet e përfshira, të krijuar në Palën tjetër Kontraktuese ose, kur vlera doganore nuk është e njohur ose nuk mund të jetë e vërtetuar, çmimi i parë i vërtetuar i paguar për materialet në Komunitet ose në Shqipëri.

j) "kapituj" dhe "krerët" do të thotë kapitujt dhe krerët (kodet katër-shifrore) të përdorura në nomenklaturë të cilat përbëjnë Përshkrimin e Harmonizuar të Mallrave dhe Sistemin e Kodeve, referuar në këtë protokoll si “Sistemi i Harmonizuar” ose “HS”;

k) "i klasifikuar" i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali nën nje kre të veçantë;

l) "dërgesa" do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohëshme nga një eksportues te një marrës ose të shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues te një marrës ose, në mungesë të një dokumenti të tille, nga një faturë e vetme;

m) "territore" përfshijnë ujërat territoriale.

TITULLI II

PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT ” PRODUKTE ORIGJINUESE”

NENI 2

Kërkesa të përgjithëshme

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtëme do të konsiderohen si origjinuese në Komunitet:

(a) produktet tërësisht të përfituara në Komunitet në përputhje me kuptimin e Nenit 5;

(b) produkte të përfituar në Komunitet që përfshijnë materiale që nuk kanë qënë tërësisht të përfituara atje, me kusht që materiale të tilla kanë kaluar në punime apo proçese të mjaftueshme në Komunitet në përputhje me Nenin 6;

2. Për qëllime te të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtëme do të konsiderohen si origjinuese në Shqipëri:

(a) produktet tërësisht të përfituara në Komunitet në përputhje me kuptimin e Nenit 5;

(b) produkte të përfituar në Komunitet që përfshijnë materiale që nuk kanë qënë tërësisht të përfituara atje, me kusht që materiale të tilla kanë kaluar në punime apo proçese të mjaftueshme në Komunitet në përputhje me Nenin 6;

NENI 3

Kumulimi Bilateral i Origjinës në Komunitet

Materialet origjinuese në Shqipëri do të konsiderohen si materiale origjinuese në Komunitet kur përfshihen në një produkt të përftuar atje.

Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar punime apo proçese të mjaftueshme, me kusht që t'i jenë nënshtruar punimeve apo proçeseve përtej atyre që u referohet Neni 7 (1).

## NENI 4

## Kumulimi Bilateral i Origjinës nëShqipëri

Materialet origjinuese në Komunitet do të konsiderohen si materiale origjinuese në Shqiperi kur përfshihen në një produkt të përftuar atje.

Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar punime apo proçese të mjaftueshme, me kusht që t'i jenë nënshtruar punimeve apo proçeseve përtej atyre që u referohet Neni 7 (1).

## NENI 5

## Produkte tërësisht të përftuara

1. Produktet e mëposhtëme do të konsiderohen si tërësisht të përfituara në Komunitet ose në Shqipëri:

(a) produkte minerale të nxjerra nga shtresat e tyre tokësore dhe nëntoka ujore e

detit;

(b) produktet bimore të korrura atje;

(c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;

(d) produkte nga kafshët e gjalla të rritura atje;

(e) produkte të përfituara nga gjuetia apo peshkimi të kryera atje;

(f) produkte të peshkimit ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të Komunitetit ose Shqipërise nga barkat e tyre;

(g) produkte të prodhuara në bordet e anijeve të tyre fabrikë ekskluzivisht nga produktet e referuara në nënparagrafin (f);

(h) artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për mbulimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatëshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje;

(i) mbetje dhe skrape të rezultuara nga operacionet e përpunimit të kryera atje;

(j) produkte të nxjerra nga shtresat ose nënshtresat tokësore në ujrat detare, jashtë ujërave të tyre territoriale, me kusht që ato kanë të drejtën vetëm këto shtresa apo nënshtresa;

(k) mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuara në nënparagrafin nga (a) deri (j).

2. Termi "barkat e tyre" dhe "anijet e tyre fabrike" në paragrafin 1(f) dhe (g) do të aplikohen vetëm për barkat dhe anijet fabrikë:

(a) të cilat janë të regjistruara ose të mbajtura në Shtetet Antare ose në Shqipëri;

(b) të cilat lundrojnë nën flamurin e Shteteve Anetare ose në Shqipëri;

(c) të cilat janë në pronësi të mbi të paktën 50 për qind nga nënshtetasit e Shteteve Antare ose Shqipërise, ose nga një kompani me zyrat e saj kryesore në një nga këto shtete, menaxheri apo menaxheret e të cilëve, Kryetari i Bordit të Drejtorëve ose Bordi Supervizor dhe shumica e anëtareve të bordeve të tilla janë nënshtetas të Shteteve Antare ose Shqipërise dhe të cilët, në shtesë, në rastin e bashkëpronësisë ose kompanive të kufizuara, të paktën gjysma e kapitalit i përket këtyre shteteve ose institucioneve publike apo nënshtetasve të Shteteve te mësipërme;

(d) e të cilit pronarët dhe zyrtarët janë nënshtetas të Shteteve Antare dhe Shqipërise; dhe

(e) e të cilit të paktën 75 për qind e ekuipazhit janë nënshtetas të Shteteve Antare ose Shqipërise .

## NENI 6

### Produkte të punuar ose të përpunuar në masë të mjaftueshme

1. Për qëllime të Nenit 2, produktet të cilat nuk janë tërësisht të përfituara konsiderohen të punuara ose kaluara në proçes të mjaftueshëm kur kushtet e vendosura në listën e Aneksit II janë plotësuar.

Kushtet e referuara në paragrafin e mësipërm, për të gjithë produktet që mbulon kjo Marrëveshje, punimi ose perpunimi nën të cilat do të kalojnë materialet jo origjinuese të perdorura për prodhim dhe do të aplikohen vetëm në lidhje me materiale të tilla. Përkatësisht nëse një produkt i cili ka kërkuar statusin e origjinës duke plotesuar kushtet e vendosura në listë, është përdorur në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e aplikueshme ndaj një produkti në të cilin ai është bashkuar nuk aplikohen në të, dhe nuk do të merren parasysh materialet jo origjinuese të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet jo origjinuese të cilat, sipas kushteve të vendosura në listë, nuk do të përdoren në prodhimin e një produkti, mund edhe të përdoren, pasi të sigurohet që :

(a) vlera e tyre totale nuk i kalon 10 për qind të çmimit ex-works të produktit;

(b) ndonjë nga përqindjet e dhëna në listë për maksimumin e vlerës së materialeve jo origjinuese nuk tejkalohen përmes aplikimit të këtij paragrafi.

Ky paragraf nuk do të aplikohet për produktet që rrjedhin nga Kapitulli 50 deri në 63 të Sistemit të Harmonizuar.

3. Paragrafet 1 dhe 2 do të aplikohen si objekt i dispozitave të Nenit 7.

## NENI 7

### Operacionet e punimeve ose përpunimeve të pamjaftueshme

1. Pa paragjykuar paragrafin 2, operacionet e mëposhtëmë do të konsiderohen si punime ose përpunime të pamjaftueshme për t'i dhënë statusin e origjinës së produktit, nëse janë plotësuar ose jo kërkesat e Nenit 5:

(a) kryerja e operacioneve për të siguruar që produkti mbahet në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;
(b) thyerjet dhe bashkimet e paketimeve;
(c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksideve, vajit, njollave apo mbetjeve te tjera;
(d) hekurosja ose presimi i tekstileve;
(e) operacionet e thjeshta të lyerjeve apo shkëlqimit;
(f) tharja, zbardhimi i pjesëshëm ose i përgjithëshëm, shkëlqimi dhe ndriçimi i farërave dhe orizit;
(g) operacionet e ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme sheqerit;
(h) qërimi, pastrimi i pjesës së brendëshme të frutave, perimeve dhe arrave;
(i) ndarjet, bluarjet ose prerjet e thjeshta;
(j) heqja e pjesëve mbuluese, mbrojtja nga demtuesit e jashtëm, përzgjedhjet, klasifikimi, përshkallëzimet dhe matjet (duke përfshire vendosjen e pjesëve të artikujve);
(k) thjesht vendosjet në shishe, kanaçe, empruveta, çanta, valixhe, kuti, sirtare, fiksimi në to i letrave ose mbështjellësve si dhe të gjithë operacionet e tjera të paketimit të thjeshtë;
(i) fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove si dhe i shënjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;
(m) përzierje e thjeshtë e produkteve, nëse po ose jo i llojeve të ndryshme;
(n) bashkimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të përfunduar një material të plotë ose ndarja e produktit në pjesë;
(o) kombinimi i dy ose më shumë operacioneve të specifikuara në nënparagrafet nga (a) ne (n);
(p) therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet që kryhen në Komunitet ose në Shqipëri në një produkt të caktuar do të konsiderohen së bashku, në rastet kur përcaktohet se punimet ose proçeset mbi të cilat ka kaluar produkti, janë të pamjaftueshme brënda kuptimit të paragrafit 1.

## NENI 8

### Njësia e Kualifikimit

1. Njësia e Kualifikimit për aplikimin e dispozitave të këtij Protokolli do të jetë produkti i veçantë i cili konsiderohet si njësi bazë kur për përcaktimin e klasifikimit përdoret nomenklatura e Sistemit të Harmonizuar.

Përkatësisht, proçedohet si më poshtë:

(a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh është i klasifikuar nën termat e Sistemit të Harmonizuar në një kre të vetëm, e tëra përbën njësinë e klasifikimit;

(b) kur një dërgesë përfaqëson një numër produktesh identike të klasifikuara nën të njëjtin kre të Sistemit të Harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht në rastin e aplikimit te dispozitave të këtij Protokolli.

2. Kur, nën Rregullin e Përgjithshëm 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet bashkë me produktin për qëllime klasifikimi, ai do të përfshihet për qëllim të përcaktimit të origjinës.

## NENI 9

### Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentat

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentat të lidhura me një pjese pajisjeje, makine, aparati apo mjeti, te cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe përfshihen në çmim të saj ose nuk janë të ndara dukshëm në faturë, do të konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit në fjalë.

NENI 10

Kompletet

Kompletet, sipas përcaktimit në Rregullin e Përgjithëshëm 3 të Sistemit të Harmonizuar, do të konsiderohen si origjinuese kur të gjithë produktet përbërës janë origjinues. Megjithatë, kur një komplet përbëhet nga produkte origjinuese dhe jo origjinuese, kompleti si i tërë do të konsiderohet si origjinues, me kusht që vlera e produkteve jo origjinuese të mos kalojë 15 për qind të çmimit "ex work" të kompletit.

NENI 11

Elementët neutrale

Me qëllim që të përcaktohet nëse një produkt është origjinues, nuk është e nevojëshme të përcaktohet origjina e zërave të mëposhtme të cilët mund të jenë përdorur gjatë prodhimit të tij:

(a) energjia elektrike dhe karburanti;

(b) toka dhe pajisjet;

(c) makineritë dhe veglat;

(d) mallrat të cilat nuk hyjnë dhe të cilat nuk synohen të përfshihen në përbërjen finale të produktit.

TITULLI III

KËRKESAT TERRITORIALE

NENI 12

Parimet e territorialitetit

1. Kushtet për përftimin e statusit origjinues të përcaktuar në Titullin II, duhet të plotësohen pa ndërprerje nga Komuniteti ose nga Shqipëria.

2. Nese, kur mallrat e eksportuara origjinuese nga Komuniteti ose nga Shqiperia në një vënd tjetër kthehen, ato duhet të konsiderohen si jo origjinuese, ndryshe kjo gjë duhet demostruar me qëllim që autoritetet doganore të binden se:

(a) mallrat e kthyera janë të njëjta me ato që jane eksportuar; dhe

(b) ato nuk kanë kaluar në ndonjë proçes tjetër përtej atyre të nevojshme për t'i ruajtur ato në kushte të mira gjatë kohës që kanë ndenjur në atë vënd ose gjatë eksportimit.

3. Përftimi i statusit origjinues në përputhje me kushtet e përcaktuara në Titullin II nuk do të ndikohen nga punime apo përpunime të kryera jashtë Komunitetit ose Shqipërisë ndaj materialeve të eksportuara nga Komuniteti ose Shqipëria dhe ri-importuar atje, duke siguruar që :

(a) materialet në fjalë janë plotësisht të përftuara në Komunitet ose Shqipëri ose mbi to janë kryer punime apo përpunime përtej operacioneve te pamjaftueshme te listuara në Nenin 7 përpara se të jenë të eksportuara ; dhe

(b) të demonstrohet për të bindur autoritetet doganore që:

(i) mallrat e ri-importuara kanë qënë përftuar nga punime apo proçese të materialeve të eksportuara; dhe

(ii) vlera totale e shtuar e përftuar jashtë Komunitetit ose Shqipërisë sipas zbatimit te dispozitave të këtij Neni, nuk kalon 10 % te çmimit "ex work" të produktit përfundimtar per të cilin është kërkuar statusi origjinues .

4. Për qëllime të paragrafit 3, kushtet për përfitimin e statusit origjinues përcaktuar në Titullin II nuk do të zbatohen për punime apo proçese të bëra jashtë Komunitetit ose Shqipërisë. Në rastet kur, në listën e Aneksit II, rregulli i përcaktuar që ka të bëjë me vlerën maksimale të të gjithë materialeve të bashkangjitura jo origjinuese, zbatohet në përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlera totale e materialeve të bashkangjitura jo origjinuese në territorin e Palës perkatëse së interesuar, marrë së bashku me vlerën totale të shtuar të përftuar jashtë Komunitetit ose Shqipërisë sipas zbatimit të dispozitave të këtij Neni, nuk duhet të tejkalojë përqindjen e përcaktuar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafit 3 dhe 4, "vlera totale e shtuar" do të merret në kuptimin e të gjithë kostove të bëra jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, perfshi dhe vlerën e materialeve te bashkangjitura atje.

6. Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk do të zbatohen ndaj produkteve që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në listën e Aneksit II dhe të cilat mund të konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme vetëm nëse zbatohen vlerat e përgjithëshme te përcaktuara në Nenin 6 (2).

7. Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk do të zbatohen për produktet e kapitujve nga 50 ne 63 të Sistemit të Harmonizuar.

8. Për ndonjë lloj punimi apo proçesi që është objekt i dispozitave të këtij Neni dhe është kryer jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, duhet proçeduar me marrëveshje të proçeduara jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, ose marrëveshje të ngjashme.

NENI 13

Transporti i drejtëpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i siguruar në Marrëveshje aplikohet vetëm për produktet, që plotësojnë kërkesat e këtij Protokolli, të cilat janë transportuar drejtëpërsëdrejti mes Komunitetit dhe Shqipërisë. Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjerë dhe, nëse paraqitet e nevojëshme, lëvizje tranzit ose magazinim i përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të mbeten nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të vendit tranzit ose të magazinimit dhe nuk kryejnë operacione të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit, ose ndonjë operacion tjetër me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira.

Produktet origjinuese mund të transportohen me nënkalime përmes territorit përveç se ndryshe nga ato të Komunitetit ose Shqipërisë.

2. Të dhënat që vërtetojnë se kushtet e vendosura në paragrafin 1 janë plotësuar tërësisht duhet ti jepen autoriteteve doganore të vendit importues, të cilat duhet të përfshijnë:

(a) një dokument të vetëm transporti që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vëndit tranzit: ose

(b) një çertifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit tranzit:

- (i) duke dhënë një përshkrim të saktë të produkteve;
- (ii) duke paraqitur datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve, ose llojet e tjera të transportit të perdorur; si dhe
- (iii) një vërtetim të kushteve nën të cilat ka qëndruar produkti në vendin tranzit:

(c) nëse nuk mundësohen këto dokumenta, ndonjë dokument tjetër thelbësor.

NENI 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese, të dërguara për ekspozim në një vend tjetër të ndryshëm nga Komuniteti ose Shqipëria do të përfitojnë në lidhje me këtë importim, nga dispozitat e Marrëveshjes, pasi të ketë siguruar autoritetet doganore që:

(a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga Komuniteti ose Shqipëria në vëndin në të cilin bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

(b) produktet janë shitur ose në të kundërt i janë vënë në dispozicion nga ky eksportues personit në Komunitet ose Shqipëri;

(c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas tij në shtetin në të cilin ato janë dërguar për ekspozim; dhe

(d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato u dërguan në ekspozitë, për ndonjë qëllim tjetër veçse atij te ekspozimit.

2. Vërtetimi i origjinës duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e Titullit V dhe të jetë depozituar pranë autoriteteve doganore të vëndit importues në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur paraqitet e nevojëshme, mund të kërkohen të dhëna shtesë dokumentare në lidhje me kushtet e ekspozimit të produkteve.

3. Paragrafi 1 do të aplikohet për çdo lloj ekspozimi, prezantimi të thjeshtë apo panairi publik tregtar, industrial, bujqësor, ose për mjete udhëtimi apo transportimi, të cilët nuk duhet të jenë të organizuara për qëllime private në dyqane apo biznese me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë, dhe gjatë të cilëve produktet i nënshtrohen kontrollit doganor.

## TITULLI IV

## TËRHEQJA OSE PËRJASHTIMI

### NENI 15

### Ndalimi i tërheqjes prej, ose përjashtimeve nga, tarifat doganore

1. Materialet jo origjinuese të përdorura në prodhimin e një produkti origjinues në Komunitet ose në Shqipëri, për të cilat vërtetimi i origjinës është lëshuar ose bërë në përputhje me

dispozitat e Titullit V nuk do të jenë subjekt, në Komunitet ose Shqipëri, subjekt tërheqjeje prej, ose përjashtimi nga, detyrimet doganore të çdo lloji.

2. Ndalimi në paragrafin 1 do të aplikohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, anullimi i borxheve ose jo-pagesave, pjesore ose tërësore, të detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera më të njëjtin efekt, të aplikueshme në Komunitet ose në Shqipëri, për materialet e përdorura në prodhim, ku rimbursimet, anullimet e borxheve ose mos-pagimet e tilla aplikohen, shprehimisht ose me efekt, kur produktet e përftuara nga materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen për përdorim shtëpiak atje.

3. Eksportuesi i produkteve mbuluar nga vërtetimi i origjinës duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojëshme që provojnë se asnjë tërheqje nuk është bërë në lidhje me materialet jo origjinuese të perdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera më të njëjtin efekt të aplikueshme në të tilla materiale aktualisht kanë qënë paguar.

4. Dispozitat e paragrafeve nga 1 në 3, gjithashtu do të aplikohen në përputhje me paketimin brënda kuptimit të Nenit 8(2), aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentat, brënda kuptimit te Nenit 9 dhe produktet në një komplet, brënda kuptimit të Nenin 10, kur përbërës të tillë nuk janë origjinues.

5. Dispozitat e paragrafeve nga 1 në 4, do të aplikohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet Marrëveshja. Për më tepër, nuk përjashtohet aplikimi i ndonjë sistemi të rimbursimit të eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshme për eksportet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.

6. Pamvarësisht nga paragrafi 1, Shqipëria mund të aplikojë rregullimet për tërheqje prej, ose përjashtime nga, tarifat doganore ose detyrime të tjera më të njëjtin efekt, të aplikueshme në materialet e përdorura në prodhimin e produkteve origjinuese, subjekt i dispozitave të mëposhtëme:

(a) një normë 5 për qind e ngarkeses doganore do të mbahet për produktet e përfshira nga Kapitulli 25 deri 49 dhe nga 64 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar, ose norma të tilla më të ulta siç është në fuqi në Shqipëri;

(b) një normë 10 për qind e ngarkesës doganore do të mbahet për produktet e përfshira nga Kapitulli 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar, ose norma të tilla më te ulta siç është në fuqi në Shqipëri.

7. Dispozitat e këtij Neni do të aplikohen nga 1 Janari 2003. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen deri më 31 dhjetor 2005 dhe mund të rishikohen me marrëveshje të përbashkët.

## TITULLI V

## VËRTETIMI I ORIGJINËS

### NENI 16

### Kërkesa të përgjithëshme

1. Produktet origjinuese në Komunitet, gjatë importimit në Shqipëri, dhe produktet origjinuese në Shqipëri me importimin në Komunitet, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje me paraqitjen ose të:

(a) një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një formë e së cilës tregohet në Aneksin III; ose

(b) në rastet e specifikuara në Nenin 21(1), të një deklaratë, teksti i të cilës parashikohet në Aneksin IV, dhënë nga eksportuesi në një faturë, njE notë dërguese ose dokument tjetër

tregtar i cili përshkruan produktet përkatëse në detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar (që këtej e me tutje do të quhet « deklaratë faturë »)

2. Pamvarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e këtij Protokolli, përsa i takon rasteve të specifikuara në Nenin 26, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje, pa qënë e nevojëshme të depozitojnë ndonjë nga dokumentet e përmendur më sipër.

## NENI 17

### Proçedurat për lëshimin e një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1

1. Një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues mbështetur në aplikimin e bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqesuesi i tij i autorizuar do të plotësojnë të dyja dokumentet, çertifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe formën e aplikimit, një shëmbull i së cilës tregohet në Aneksin III. Këta formularë do të plotësohen në një nga gjuhët në të cilat ështe hartuar kjo Marrëveshje dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vëndas të vëndit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato do të plotësohen me bojë me gërma kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në një kuti të rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, një vijë horizontale duhet të hiqet poshtë vijës së fundit së përshkrimit, përmes hapësirës boshe.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1 do të përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vëndit eksportues ku çertifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 është lëshuar, të gjitha dokumentat e

nevojëshme që provojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

4. Një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të një Shteti Antar ose Shqipërisë nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen me origjinë në Komunitet ose në Shqipëri dhe plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokolli.

5. Autoritetet doganore që lëshojnë çertifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 do të ndërmarrin masa apo hapa të nevojëshem për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo evidencë apo të ndërmarrin ndonjë inspektim të llogarive financiare të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojëshem. Autoritetet doganore në lëshimin e çertifikatave të tilla gjithashtu do të sigurojnë që formularët referuar paragrafit 2 janë të plotësur përkatësisht. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa fallco.

6. Data e lëshimit të një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të tregohet në Kutinë 11 të çertifikatës.

7. Një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore dhe do të bëhet e vlefshme për eksportuesin sa më shpejt që eksportimi aktual të jetë kryer ose siguruar.

## NENI 18

## Çertifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1 të lëshuara aposteriori

1. Pavarësisht nga Neni 17(7), një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 mund përjashtimisht të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilëve iu referohet, nëse:

(a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta; ose

(b) është demonstruar pranë autoriteteve doganore që një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 është lëshuar por nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Për zbatimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vëndin dhe datën e eksportimit të produkteve për të cilat çertifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet, dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.

3. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 aposteriori vetëm pasi të jetë verifikuar së informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese.

4. Çertifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar aposteriori duhet të mbyllet me një nga frazat e mëposhtëme:

"NACHTRÄGLICH AUSGESTELLT", "DELIVRE A POSTERIORI",

"RILASCIATO A POSTERIORI", "AFGEGEVEN A POSTERIORI",

"ISSUED RETROSPECTIVELY", "UDSTEDT EFTERFØLGENDE",

"ΕΚΔΟΘΕΝ ΕΚ ΤΩΝ ΥΣΤΕΡΩΝ", "EXPEDIDO A POSTERIORI",

"EMITIDO A POSTERIORI", "ANNETTU JÄLKIKÄTEEN",

"UTFÄRDAT I EFTERHAND", "D O P O L N I T E L N O I Z D A D EN O"

"NAKNADNO IZDANO"

5. Mbyllja referuar paragrafit 4 do të vendoset në kutinë "vërejtje" të çertifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

## NENI 19

### Lëshimi i Duplikatit të një çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1

1. Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1, eksportuesi mund të aplikojë tek autorietet doganore të cilat e kanë lëshuar atë për një dublikatë që bëhet në bazë të dokumentave të eksportit në zotërim të tyre

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me një nga fjalët e mëposhtëme;

"DUPLIKAT", "DUPLICATA", "DUPLICATO", "DUPLICAAT", "DUPLICATE",
"ΑΝΤΙΓΡΑΦΟ", "DUPLICADO", "SEGUNDA VIA", "KAKSOISKAPPALE",
"D U P L I K A T" "DUPLIKAT"

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 do të vendoset në kutinë "Vërejtje" të dublikatës të çertifikatës të qarkullimit të mallrave EUR.1.

4. Dublikata e cila duhet të tregojë dhe datën e lëshimit të çertifikatës origjinale të qarkullimit të mallrave EUR, do të ketë fuqi dhe nga ajo datë.

## NENI 20

### Lëshimi i çertifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 mbi bazën e vërtetimit të origjinës të lëshuar ose bërë më parë

Kur produktet origjinuese janë vendosur nën kontrolin e një zyre doganore në Komunitet ose Shqipëri, do të jetë e mundur të zëvëndësohet me vërtetimin origjinal të origjinës me një ose më shumë çertifikata të qarkullimit të mallrave EUR.1 për qëllime të dërgimit të të gjitha ose disa nga këto produkte diku brënda Komunitetit ose Shqipërisë. Zëvëndësimi i çertifikatës/ave të qarkullimit të mallrave EUR.1 do të lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës janë të vendosura këto produkte.

## NENI 21

### Kushtet për lëshimin e një Deklarate Faturë

1. Një deklaratë faturë, siç i referohet në Nenin 16(1) (b) mund të përgatitet:

   (a) nga një eksportues i aprovuar në kuptimin e Nenit 22, ose

   (b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese vlera totale e të cilave nuk i kalon 6 000 Euro .

2. Një deklaratë faturë mund të lëshohet nëse produktet në fjalë konsiderohen si produkte origjinuese në Komunitet ose Shqipëri dhe plotëson të gjitha kërkesat e tjera të këtij Protokolli.

3. Eksportuesi që përgatit një deklaratë faturë duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vëndit eksportues, të gjitha dokumentat e nevojëshme që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

4. Një deklaratë faturë duhet të lëshohet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar, ose printuar mbi faturën, notën shpërndarëse ose ndonjë dokument tjetër tregtar, teksti i së cilës jepet në Aneksin IV, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në atë Aneks dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vëndas të vëndit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë në gërma kapitale.

5. Një deklaratë faturë duhet të ketë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë. Sidoqoftë, një eksportues i aprovuar në kuptimin e Nenit 22, nuk do t'i kërkohet të nënshkruajë deklarata të tilla duke siguruar që u paraqet autoriteteve doganore të vëndit eksportues një deklaratë me shkrim ku ai pranon të gjitha përgjegjësitë për një deklaratë faturë e cila e identifikon atë me ç'ka është nënshkruar me shkrim dore prej tij.

6. Një deklaratë faturë mund të bëhet nga një eksportues kur produktet me të cilat ai ka lidhje eksportohen, ose mbas eksportimit me kusht që ai është paraqitur në vëndin importues jo më vonë se dy vjet mbas importimit të produkteve të cilave ai i referohet.

NENI 22

Eksportuesi i aprovuar

1. Autoritetet doganore të vëndit eksportues mund të autorizojnë çdo eksportues, këtu e më pas të referuar si "eksportuesi i aprovuar", që bën dërgesa të shpeshta të mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje, të lëshojë deklaratë fature, pamvarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojëshme për të vërtetuar statusin e origjinës së produkteve si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të aprovuar, kur ata e gjykojnë të përshtatëshme

3. Autoritetet doganore do t'i japin eksportuesit të aprovuar një numër autorizimi doganor i cili do të shfaqet në deklaratën faturë.

4. Autoritetet doganore do të kontrollojnë përdorimin e autorizimeve nga eksportuesi i aprovuar.

5. Autoritetet doganore mund të tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata mund ta bëjnë këtë kur eksportuesi i aprovuar nuk ofron garancitë referuar paragrafit 1, si dhe nuk plotëson kërkesat referuar paragrafit 2, ose në të kundërt kryen përdorim jo korrekt të autorizimit.

NENI 23

Vlefshmëria e vërtetimit të origjinës

1. Vërtetimi i origjinës do të jetë i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në vëndin eksportues, dhe duhet depozituar brënda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të vëndit importues.

2. Vërtetimi i origjinës të cilat janë depozituar pranë autoriteteve doganore të vëndit importues pas datës së fundit për paraqitje, e specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim zbatimin e trajtimit preferencial, kur nuk është arritur depozitimi i këtyre dokumentave deri në datën përfundimtare, shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonëshme.

3. Në rastet e tjera të depozitimeve shumë të vonuara, autoritetet doganore të vëndit importues mund ta pranojnë vërtetimin e origjinës kur produktet janë depozituar përpara datës përfundimtare.

## NENI 24

### Paraqitja e vërtetimit të origjinës

Vërtetimi i origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore të vëndit importues në përputhje të plotë me proçedurat që aplikohen në atë vënd. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë një përkthim të vërtetimit të origjinës dhe gjithashtu mund të kërkojnë deklaratën e importit që duhet t'i bashkangjitet një deklarimi nga importuesi që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

## NENI 25

### Importi me dergesë të parë

Kur, me kërkesen e importuesit dhe me kushtet e parashtuara nga autoritetet doganore të vëndit importues, produktet e ndara ose jo të grupuara në kuptimin e Rregullit të Përgjithshëm 2(a) të Sistemit të Harmonizuar, që është në Seksionin XVI dhe XVII apo në Krerët Nr. 7308 dhe 9406, janë importuar me dërgesë të parë, një vërtetim i origjinës për të tilla produkte duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të dërgesës së parë.

## NENI 26

### Përjashtimet nga *Vërtetimi i origjinës*

1. Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privat tek personat privat ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve do të pranohen si produkte origjinuese pa kërkuar paraqitjen e vërtetimit të origjinës, nëse sigurohet se këto produkte nuk janë importuar për

qëllime tregtie dhe janë deklaruar se plotësojnë kërkesat e ketij Protokolli dhe aty ku nuk ka dyshim te vërtetësia e një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarimin doganor CN22/CN23 ose në një fletë të veçantë letre që do t'i aneksohet atij dokumenti.

2. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari ose familjarët e tyre nuk do të konsiderohen si importe për qëllime tregtie nëse nisur nga pikpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është evidente që nuk ka qëllime tregtie për to.

3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojnë 500 Euro në rastin e pakove të vogla ose 1 200 Euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve.

NENI 27

Dokumentat Mbështetëse

Dokumentat referuar në Nenin 17(3) dhe 21(3) që përdoren për qëllime vërtetimi se produktet e shoqëruara me një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose një deklaratë faturë, mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Komunitet ose në Shqipëri dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera të këtij Protokolli, si dhe mund të konsistojnë midis të tjerave si të mëposhtëmet:

(a) evidencë direkte e proçeseve të kryera nga eksportuesi ose ofruesi për të përfituar produktet në fjalë, që mbahen për shëmbull në llogaritë ose në librat e kontabilitetit të tij të brëndëshëm;

(b) dokumentat që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Komunitet ose në Shqipëri ku këto dokumenta përdoren në përputhje me ligjin vëndas;

(c) dokumentat që vërtetojnë punimet ose proçeset e prodhimit të materialeve në Komunitet ose në Shqipëri, të lëshuara ose të bëra në Komunitet ose në Shqipëri, ku këto dokumenta janë përdorur në përputhje me ligjin vendas;

(d) çertifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose deklarata faturë që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Komunitet ose në Shqipëri në përputhje me këtë Protokoll.

## NENI 28

### Ruajtja e vërtetimit të origjinës dhe e dokumentave mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një çertifikate qarkullimi mallrash EUR.1 duhet t'i mbajë dokumentat referuar në Nenin 17 (3) për të paktën tre vjet.

2. Eksportuesi që bën një deklaratë faturë duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklarate si dhe dokumentat referuar në Nenin 21 (3).

3. Autoritetet doganore të vëndit eksportues që lëshojnë një çertifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit referuar në Nenin 17(2).

4. Autoritetet doganore të vëndit importues duhet të mbajnë për të paktën tre vjet çertifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë që iu paraqiten atyre.

NENI 29

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Në rast se gjenden mosperputhje të vogla në deklarimet e bëra në vërtetimin e origjinës dhe ato të bëra në dokumentat e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve, kjo nuk do të sjellë pavlefshmërinë e vërtetimit të origjinës nëse është evidentuar se ky dokument i korrespondon produkteve të paraqitura.

2. Gabimet formale të dukshme të tilla si gabime gjatë shtypjes në vërtetimin e origjinës nuk do të bëhen shkas që ky dokument të anullohet, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklarimit të bërë në atë dokument.

NENI 30

Sasitë e shprehura në Euro

1. Në zbatim të dispozitave të Nenit 21(1)(b) dhe Nenit 26(3) në rastet kur produktet faturohen në një monedhë tjetër veç euros, sasia në monedhën kombëtare të Shteteve Antare ose Shqipërisë, ekuivalente me shumat e shprehura në euro, duhet të fiksohet çdo vit nga sejcila Palë.

2. Një dërgesë malli duhet të përfitojë nga dispozitat e Nenit 21(1)(b) dhe Nenit 26(3), duke ju referuar monedhës në të cilën është përgatitur fatura, sipas shumës së fiksuar nga Komuniteti ose Shqipëria.

3. Shumat për t'u përdorur në çdo lloj monedhe kombëtare duhet të jenë të barabarta me këtë monedhë të shumës së shprehur në euro si në ditën e parë të punës së muajit tetor. Shuma do t'i komunikohen Komisionit të Kominitetit Europian më 15 tetor dhe do të aplikohen nga 1 janari i vitit pasues. Komisioni i Komunitetit Europian do të njftojë Shqipërinë mbi shumat përkatëese.

4. Shqipëria mund të rrumbullakosë më lart ose më poshtë shumën që rezulton nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare të një shume të shprehur në euro. Sasia e rrumbullakosur nuk duhet të ndryshojë nga sasia e rezultuar prej konvertimit me më shumë se 5%. Shqipëria mund të mbajë të pandryshuar ekuivalentin e monedhës së saj kombëtare të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së axhustimeve vjetore, sipas paragrafit 3, konvertimi i kësaj shume, përpara rrumbullakosjes, rezulton me një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare. Ekuivalenti i monedhës kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi do të rezultonte në një pakësim në këtë vlerë ekuivalente.

5. Shumat e shprehura në euro duhet te rishikohen nga Komiteti i Stabilizim Asocimit me kërkese të Komunitetit ose Shqipërisë. Kur të kryejë këtë rishikim, Komiteti i Stabilizim Asocimit duhet të konsiderojë dëshirën për t'u mbrojtur nga pasojat e efekteve të kufizimeve në terma reale. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë për të modifikuar shumat e shprehura në euro.

## TITULLI VI

## RREGULLIME PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

### NENI 31

### Asistenca Reciproke

1. Autoritetet doganore të Shteteve Antare dhe Shqipërisë duhet t'i sigurojnë njëra-tjetrës nëpërmjet Komisionit të Komunitetit Europian kopje të llojit të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e çertifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe adresat e autoriteteve përgjegjëse doganore për të vërtetuar këto çertifikata dhe deklarata faturë.

2. Me qëllim që të sigurohet aplikimi i duhur i ketij Protokolli, Komuniteti dhe Shqipëria duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të çertifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose të deklaratave faturë, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumenta.

### NENI 32

### Verifikimi i vërtetimit të origjines

1. Verifikimet e duhura të vërtetimit të origjines duhet të kryhen me metodën e zgjedhjes së rastit ose sa herë që autoritetet doganore të vëndit importues kanë dyshime të arësyeshme për origjinalitetin e dokumenteve të tillë, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vëndit importues duhet t'ja kthejnë çertifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë, në rast se është paraqitur, ose një kopje të këtyre dokumentave, autoriteteve doganore të vëndit eksportues, duke u dhënë, atëhere kur është e nevojëshme, arësyet për hetimin. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili thotë se informacioni i dhënë mbi vërtetimin e origjinës është jo korrekt, duhet t'i bashkangjitet në mbështetje të kërkesës për verifikim.

3. Verifikimi duhet të kryhet nga autoritetet doganore të vëndit eksportues. Për këtë qëllim, ato duhet të kenë të drejtën të thërrasin për çdo dokument dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i nevojshëm.

4. Në rast se autoritetet doganore të vëndit importues vendosin të pezullojnë përkohësisht dhënien e trajtimit preferencial për produktet respektive, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundësia për të mos i bllokuar produktet, vetëm në rastet e marrjes së ndonjë masë kujdesi kur gjykohet e nevojëshme.

5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejtë që të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë kur dokumentat jane origjinale dhe kur produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte që janë origjinuese në Komunitet ose Shqipëri si dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokolli. Aty ku dispozitat e kumulimit në përputhje me nenin 3 dhe 4 të ëtij Protokolli janë aplikuar dhe në lidhje me Nenin 17.3 përgjigja do të përfshijë një kopje (kopje) të çertifikatës (çertifikatave) së qarkullimit të mallrave ose deklaratë (deklaratave) faturës në të cilën është mbështetur.

6. Në rast se për një dyshim të arësyeshëm, nuk ka përgjigje brënda dhjetë muajve nga data e kërkesës së verifikimit, ose në qoftë se pergjigjja nuk përmban informacion të mjaftueshem për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuese të hetimit, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonëshme, duhet të refuzojnë dhënien e preferencave.

NENI 33

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me verifikimin e proçedurave të Nenit 32, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë një verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ose kur ato ngrejnë një çeshtje lidhur me interpretimin e këtij Protokolli, ato duhet t'i paraqiten Komitetit të Stabilizim Asocimit.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vëndit importues duhet të respektojnë legjislacionin e vëndit importues.

NENI 34

Gjobat

Gjobat duhet të vendosen mbi çdo person që fsheh, ose shkakton fshehjen e një dokumenti që përmban informacion jo korrekt për qëllimin e marrjes së trajtimit preferencial për produktet.

NENI 35

Zonat e lira

1. Kuminitti dhe Shqipëria do të marrin të gjitha masat e nevojëshme për të siguruar që produktet e tregtuara që janë objekt i vërtetimit të origjinës, dhe që gjatë transportit përdorin një

zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvëndësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë përpunim tjetër veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqesimin e gjëndjes së mallrave.

2. Në kuptimin e një përjashtimi nga dispozitat që përmban paragrafi 1, kur produktet origjinuese nëKomunitet ose Shqipëri, importohen në një zonë të lirë me një vërtetim origjine dhe pësojne trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një çertificate të re EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli.

## TITULLI VII

## CEUTA DHE MELILLA

### NENI 36

### Zbatueshmëria e Protokollit

1. Termi "Komunitet" i përdorur në Nenin 2 nuk përfshin Ceuta dhe Melilla.

2. Produktet origjinuese në Shqipëri kur importohen në Ceuta dhe Melilla do të përfitojnë në të gjitha drejtimet të njëjtin rregjim doganor si ai që aplikohet për prouktet me origjinë në territoret doganore të Komunitetit sipas Protokollit 2 të Aktit te Anëtarësimit të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës Portugeze në Komunitetin Europian. Shqipëria do t'ju akordojë produkteve të importuara që përfshihen në këtë Marrëveshje dhe me origjinë ne Ceuta dhe

Melilla të njëjtin rregim doganor që aplikon edhe për produktet e importuara dhe origjinuese nga Komuniteti.

3 Për qëllimin e aplikimit të paragrafit 2, në lidhje me produktet origjinuese në Ceuta dhe Melilla, ky Protokoll do të aplikohet *mutatis mutandis* subjekt i kushteve specifike të parashikuara në Nenin 37.

NENI 37

Kushtet specifike

1. Duke patur parasysh se ato janë transportuar drejtë për së drejti në përputhje me dispozitatat e nenit 13, sa më poshtë do të konsiderohet se :

(1) Produkte origjinuese ne CEUTA dhe MELILLA:

(a) produkte të përfituara tërësisht në CEUTA dhe MELILLA;

(b) produkte të përfituara në CEUTA dhe MELILLA në prodhimin e të cilave janë përdorur produkte të tjera nga ato të përmendura në paragrafin (a), me kusht që:

i. produktet që thamë kanë kaluar një punë ose përpunim të mjaftueshëm, sipas kuptimit të nenit 6, të këtij protokolli, ose qe

ii. këto produkte janë origjinuar në Shqipëri ose në Komunitet sipas kuptimit të këtij protokolli, me kusht që ato ti jenë nënshtruar

punimit ose përpunimit i cili shkon më tej se punimi ose përpunm i i pamjaftueshëm që përmendet në nenin 7.1.

(2) Produktet me origjine në Shqipëri:

(a) produkte të përfituara tërësisht në Shqipëri;

(b) produkte të përfituara në Shqipëri në prodhimin e të cilave janë përdorur produkte të tjera nga ato të përmendura në paragrafin (a), me kusht që:

(i) produktet që thamë kanë kaluar një punë ose përpunim të mjaftueshëm, sipas kuptimit të nenit 6, të këtij protokolli, ose që

(ii) këto produkte janë origjinuar në CEUTA dhe MELILLA ose në Komunitet sipas kuptimit të këtij protokolli, me kusht që ato ti jenë nënshtruar punimit ose përpunimit i cili shkon më tej se punimi ose përpunm i i pamjaftueshëm që përmendet në nenin 7.1.

3. CEUTA dhe MELILLA do të konsiderohen si një territor i vetëm

4. Eksportuesit ose përfaqësuesi i tij i autorizuar do të hyjnë "Shqipëria" dhe "CEUTA dhe MELILLA" në kutinë 2 të çertifikatës EUR.1 të qarkullimit të mallrave ose me deklaratat faturë. Në shtesë, në në rastin e produkteve origjinuese ne CEUTA dhe MELILLA, kjo do të paraqitet në kutinë 4 të çertifikat.1 të qarkullimit të mallrave ose në deklaratat faturë.

5. Autoritetet doganore spanjolle do të jenë përgjegjëse pë zbatueshmërinë e këtij protokolli në CEUITA dhe MELILLA.

# TITULLI VII

# DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

## NENI 38

## Amendimet e Protokollit

Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të vendosë për të amenduar dispozita të këtij Protokolli.

**SHTOJCA I,**

SHËNIME PREZANTUESE TË LISTËS NË SHTOJCEN II

Shënim 1:

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brënda kuptimit të nenit 6 të këtij Protokolli.

Shënim 2:

2.1. Dy kollonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kollona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në Sistemin e Harmonizuar dhe kollona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo Kapitull. Për seicilën hyrje në dy kolonat e para një rregull specifikohet në kollonën 3 ose 4. Ku, në disa raste, hyrja në kollonën e parë parapritet nga një "ex" kjo nënkupton se rregullat në kollonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreu sikurse është përshkruar në kollonën 2.

2.2. Ku shumë numra krerësh grupohen së bashku në kollonën 1 ose një numër Kapitulli jepet dhe përshkrimi i produkteve në kollonën 2 prej këtej jepet në terma të përgjithshem, rregullat e afërta në kollonen 3 ose 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën Sistemin e Harmonizuar klasifikohen në krerët e Kapitullit ose në çdo kre të grupuar së bashku në kollonën 1.

2.3. Kur ka rregulla të ndryshme në listën që aplikohet për produkte të ndryshme brënda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të mbuluar nga rregullat e afërta në kollonën 3 ose 4.

2.4. Kur, për një hyrje në dy kollonat e para, një rregull specifikohet në të dyja kollonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë, si alternativë, që të aplikojë ose rregullin e vendosur në kollonën 3, ose atë të vendosur në kollonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjine në kollonën 4, duhet të aplikohet rregulli i vendosur në kollonën 3.

Shënim 3:

3.1. Dispozitat e Nenit 6, përsa i përket produkteve që kanë marrë statusin origjinues, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, duhet të aplikohen, pa patur parasysh nëse statusi është marrë brënda në fabrikën ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrike në Shqipëri ose në Komunitet.

Shëmbull:

*Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve jo origjinuese të cilat mund të përfshihen në të nuk mund të kalojë 40% të çmimit "ex-works" është bërë nga "aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kudhër" të kreut ex 7224.*

Në rast se ky çelik i temperuar është temperuar në Shqipëri nga një lende e parë jo origjinuese, ky çelik ka marrë tashmë statusin origjinues sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi mund të llogaritet atëhere si origjinues në vlerën e llogariur për motorrin, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë ose në një tjetër në Shqipëri. Vlera e lëndës së parë jo-origjinuese në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur shtohet vlera e materialeve jo origjinuese të përdorura.

3.2. Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punës ose të përpunimit, si dhe kryerja e më shumë pune apo përpunimi gjithashtu i jep statusin origjinues; në të kundërt, kryerja e më pak pune apo përpunimi nuk mund t'i japë statusin origjinues. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material jo origjinues, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëhere përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm.

3.3. Pa paragjykim për Shënimin 3.2, kur një rregull thotë se "materialet e çdo kreu" mund të përdoren, materialet e të njëjtit kre si produkti mund të përdoren, por ato janë subjekt, sidoqoftë, i ndonjë kufizimi specifik, i cili gjithashtu mund të përmbahet në rregull.

Sidoqoftë, shprehja "prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të kreut Nr…." do të thotë që vetëm materiale të klasifikuara në të njëjtin kre si dhe produkti dhe të një përshkrimi të ndryshëm nga ai i produktit sikurse i dhënë në kollonën 2 të listës, mund të përdoren.

3.4. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që një ose më shumë materiale mund të përdoren. Ai nuk kërkon që te gjitha materialet të përdoren.

Shëmbull:

Rregulli për fabrikate të krerëve 5208 deri 5212 thotë se fibrat natyrale mund të përdoren dhe se materialet kimike, ndërmjet materialeve të tjera, gjithashtu mund të përdoren. Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren; është e mundur të përdoret njëra, ose tjetra, ose që të dyja.

3.5. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material i veçantë, ky kusht duket se nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera, sepse, për

shkak të natyrës së tyre, nuk mund të kënaqin rregullin. (shiko gjithashtu Shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet)

Shëmbull:

Rregulli për ushqimet e përgatitura në kreun 1904, i cili në mënyrë specifike përjashton përdorimin e drithrave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kriprave minerale, e kimikateve dhe shtesave të tjera, të cilat nuk janë prodhime nga drithrat.

Megjithatë, kjo nuk aplikohet tek produktet, të cilat edhe pse nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuara në listë, mund të prodhohen nga nje material i së njëjtës natyrë në një stad më të hershëm të prodhimit.

Shëmbull:

Në rastin e një artikulli veshjeje të ex Kapitulli 62, i përbëre nga materiale jo të thurura, në rast se perdorimi i vetëm i fillit joorigjinues lejohet për këtë lloj artikulli, nuk është e mundur të fillosh nga pëlhure jo e thurur – edhe në se pëlhurat jo të thurura normalisht nuk mund të bëhen prej filli. Në raste të tilla, materiali fillestar duhet të jetë në një stad përpara të qënit fill, pra në gjëndjen fibër.

3.6. Kur, në një rregull në listë, jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve jo origjunuese që mund të përdoren, atëhere këto përqindje mund të mos shtohen së bashku. Me fjalë të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve jo origjinuese të përdorura nuk mund kurrë të kalojë përqindjen më të lartë të dhënë. Për më tepër, përqindjet individuale nuk duhet të tejkalohen, në lidhje me materialet e veçanta për të cilat ato aplikohen.

Shënim 4:

4.1. Termi "fibra natyrale" përdoret në listë për t'ju referuar fibrave të tjera nga ato artificiale ose sintetike. Kufizohet për stadet përpara se të ndodhë tjerrja, duke përfshirë mbetjet dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë përdredhur, krehur ose përpunuar ndryshe, por që nuk janë kthyer në fill.

4.2. Termi "fibra natyrale" përfshin qimen e kalit të kreut Nr. 0503, mëndafshin e krerëve Nr. 5002 dhe Nr. 5003, po ashtu si dhe fibrat e leshit dhe qime të imët ose të ashpër kafshe të krerëve Nr. 5101 deri Nr. 5105, fibra pambuku të krerëve Nr. 5201 deri Nr. 5203, si dhe fibra të tjerë vegjetale të krerëve Nr. 5301 deri Nr. 5305.

4.3. Termat "pulp tektili", "materiale kimike" dhe "materiale për prodhim letre" përdoren në listë për të përshkruar materialet, e paklasifikuara në Kapitujt 50 deri 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra ose fije artificiale, sintetike ose letre.

4.4. Termi "fibra kryesore të bëra nga njeriu" përdoret në listë për t'ju referuar filamenteve artificiale apo sintetike, fibrave zëvëndësuese ose mbetjeve, të krerëve Nr. 5501 deri Nr. 5507.

Shënim 5:

5.1. Aty ku, për një produkt të dhënë në listë, i referohet këtij Shënimi, kushtet e vendosura në Kollonën 3 nuk duhet të aplikohen për ndonjë material bazë tekstili të përdorur në prodhimin e këtij produkti dhe të cilat, të marra së bashku, përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës totale të materialeve bazë tekstile të përdorura. (Shiko gjithashtu Shënimet 5.3 dhe 5.4 me poshtë)

5.2. Sidoqoftë, toleranca e përmendur në Shënimin 5.1 mund të aplikohet vetëm tek produktet e përziera, të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstili bazë.

Materialet tekstile bazë, jepen si më poshtë :

- mendafsh,
- lesh,
- qime kafshe e ashpër,
- qime kafshe e hollë,
- qime kali,
- pambuk,
- materiale për prodhim letre dhe letër,
- fije liri,
- fije kërpi,
- jute dhe fibra të tjera tekstili,
- sisal dhe fibra të tjera të gjinisë “Agave”,
- fibra nga arra kokosi, abaka, ramie dhe fibra të tjera vegjetale tekstile,
- filamente sintetike të bëra nga njeriu,
- filamente artificiale të bëra nga njeriu,
- filamente percjellëse rryme,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polipropileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliesteri,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliamidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili,

- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliimidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polifenileni sulfid,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polivinilkloridi,
- fibra të tjera sintetike të bëra nga njeriu,
- fibra artificiale të bëra nga njeriu prej viskoze,
- fibra të tjera artificiale të bëra nga njeriu,
- fill i bere nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibel prej polieteri, i përdredhur ose jo,
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibel prej poliesteri, i përdredhur ose jo,
- produkte të kreut Nr. 5605 (fill i metalizuar), që përmban një rrip të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulese prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me një gjërësi që nuk kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik,
- produkte të tjera të kreut Nr. 5605.

Shëmbull:

Një fill, i kreut Nr. 5205, i bërë nga fibra pambuku të kreut Nr. 5203 dhe fibra sintetike të kreut Nr. 5506, është një fill i përzier. Për këtë arësye, fibrat sintetike jo origjinuese, të cilat nuk plotësojnë rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike ose pulp tekstili) mund të përdoren deri 10% ndaj peshës te fillit.

Shëmbull:

Një copë pelhurë leshi e kreut Nr. 5112, e bërë prej prej filli leshi të kreut Nr. 5107 dhe filli sintetik prej fibrash të kreut Nr. 5509, është një pëlhure e përzier. Për këtë arësye, filli sintetik i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike pulp tekstili), ose filli i leshit, i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga fije natyrale, jo të përdredhura apo tjerrura, ose të përgatitura ndryshe per fill), ose një kombinim i të dyjave, mund të përdoret, në rast se pesha e tyre totale nuk e kalon 10% të pëlhurës.

Shëmbull:

Pelhurë tekstile, xhufke, e kreut Nr. 5802, e bërë prej filli pambuku të kreut Nr. 5205 dhe pëlhure pambuku të kreut Nr. 5210, është vetëm një produkt i përzier në rast se pëlhura e pambukut është në vetvete një pëlhure e përzier, e prodhuar nga filli të klasifikuara në dy krerë të ndryshëm, ose në rast se filli i pambukut i përdorur është vetë një përzierje.

Shëmbull:

Nëse pëlhura tekstile, xhufkë në fjalë do të ishte e përberë nga fill pambuku i kreut Nr. 5205 dhe pëlhurë sintetike e kreut Nr. 5407, atëhere, në mënyrë të dukshme, fijet e përdorura janë dy materiale bazë tekstili të veçanta dhe pëlhura tekstile xhufkë është, mbi këto baza, një produkt i përzier.

5.3. Në rastin e produkteve që përfshijnë “fill të bërë nga poliuretani i segmentuar me segmente fleksibel të polieterit, të përdredhur ose jo”, kjo tolerancë është 20% në lidhje me kete fill.

5.4. Në rastin e produkteve që përfshijnë “rrip i përbërë nga një shtrese alumini ose nga një shtresë prej filmi plastik, të mbuluar ose jo me pluhur alumini, me një gjërësi që nuk e kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik, kjo tolerancë është 30% në lidhje me këtë rrip.

Shënim 6:

6.1. Ku në listë, i referohesh këtij shënimi, materialet tekstile (me përjashtim të linjave dhe interlinjave), të cilat nuk plotesojnë rregullin e vendosur në listë në kollonën 3 për produktin në fjalë, mund të përdoren, me kusht që ato janë klasifikuar në një kre ndryshe nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos kalojë 8% të çmimit “ex-works” të produktit.

6.2. Pa paragjykuar Shënimin 6.3, materialet, të cilat nuk janë klasifikuar brënda Kapitujve 50 deri 63, mund të përdoren lirshëm në prodhimin e produkteve tekstile, përmbajnë apo jo tekstile.

Shëmbull:

Në rast së një rregull në listë thotë që, për një lloj të veçante tekstili (të tilla si pantallonat) duhet përdorur fill, kjo nuk parandalon përdorimin e gjërave metalike, të tilla si butonat, për arësye se butonat nuk janë të klasifikuar në kapitujt 50 deri 63. Për të njëjtën arësye, nuk parandalohet përdorimi i zinxhirave, edhe pse zinxhirat normalisht përmbajnë tekstil.

6.3. Kur një rregull përqindjeje aplikohet, vlera e materialeve të cilat nuk klasifikohen brënda Kapitujve 50 deri 63, duhet të merren parasysh kur llogaritet vlera e materialeve jo origjinuese të përfshira.

Shënim 7:

7.1. Për qëllimet e krereve Nr. ex . 2707, Nr. 2713 deri Nr. 2715,. ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, “proçeset specifike" janë si më poshtë:

(a) distilim në vakum;

(b) ri-distilim nga një proçes shumë i plotë fraksionimi 17;

(c) ndarja;

(d) riformimi;

(e) përftimi me ndihmën e solventeve selektive

(f) proçesi që përfshin të gjitha operacionet e mëposhtëme: përpunimi me acid sulfurik të përqëndruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjente alkaline; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

(g) polimerizimi;

(h) alkilizimi;

(i) izomerizimi.

7.2. Për qëllimet e krerëve Nr. 2710, 2711 dhe 2712, "proçeset specifike" janë si më poshtë:

(a) distilim në vakum

(b) ri-distilim nga nje proçes shumë i plotë fraksionimi18;

(c) ndarja;

(d) riformimi;

(e) ekstraktimi me ndihmën e solventeve selektive;

(f) proçesi që përfshin të gjitha veprimet e mëposhtëme: përpunimi me acid sulfurik të përqëndruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjente alkaline; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

(g) polimerizimi;

---

[17] Referoju Shënimit 4 (b) (Shpjeguese Shtesë) I kapitulit 27 të Nomenklaturës së Kombinuar
[18] Referoju Shënimit 4 (b) (Shpjeguese Shtesë) I kapitulit 27 të Nomenklaturës së Kombinuar

(h) alkilizimi;

(ij) izomerizimi;

(k) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut Nr. ex 2710, desulfurizimi me hidrogjen, i cili rezulton nga një pakësim prej së paku 85 % të përmbajtjes së sulfurit të produkteve të përpunuara (Metoda ASTM D 1266-59 T);

(l) në lidhje vetëm me produktet e kreut Nr. 2710, deparafinimi nga një proçes tjetër nga filtrimi;

(m) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut Nr. ex 2710, trajtimi me hidrogjen, në një presion prej më shumë se 20 bar dhe një temperaturë prej më shumë se 250 °C, me përdorimin e një katalizatori, tjetër nga sjellja e desulfurizimit, kur hidrogjeni përbën një element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut Nr. ex 2710 (p.sh. hidrombarimi ose çngjyrimi), me qellim që, në mënyrë më specifike, të përmiresohet ngjyra ose stabiliteti; ky trajtim nuk duhet sidoqofte të konsiderohet një proçes specifik;

(n) në lidhje vetëm me vajrat për karburante të kreut Nr. ex 2710, distilim atmosferik, në kushte kur më pak se 30 %, sipas volumit, e këtyre produkteve distilohet, duke përfshirë humbjet, në 300 °C, me metodën ASTM D 86;

(o) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të tjera nga vajrat e gazrave dhe vajrat për karburante të kreut Nr. ex 2710, trajtim me anë të shkarkesave fshirëse të tensionit të lartë.

(p) në lidhje me prodhimet e papërpunuara (të tjera përveç xhelit të naftës, ozokorite, dyllit linjit ose dyll torfë, dyllit të parafinës, që përmban si peshë në më pak se 0.75% të vajit) vetëm të kreut ex. 2712, çvajimin nga kristalizimi fraksional.

7.3. Për qëllimet e krerëve Nr. ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, operacione të thjeshta, të tilla si pastrimi, dekantimi, çkripëzimi, ndarja e ujrave, filtrimi, ngjyrimi, vendosja e markës, përftimi i përmbajtjes sulfure si rezultat i përzjerjes të produkteve me përmbajte të ndryshme sulfuri, ose çdo lloj kombinimi të këtyre operacioneve ose operacioneve të ngjashme, nuk japin origjinë .

**SHTOJCA II**

LISTA E OPERACIONEVE TË PËRPUNIMIT OSE PROCESEVE QË KËRKOHET T'I NËNSHTROHEN MALLRAT JO-ORIGJINUESE, NË MËNYRË QË PRODUKTI PËRFUNDIMTAR TË PËRFITOJË STATUSIN E ORIGJINËS

Produktet e përfshira në këtë listë ndoshta jo të gjithë janë të mbuluara nga kjo Marreveshje. Kjo e bën të domosdoshme konsultimin me pjesët e tjera të marrveshjes.

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| Kapitulli 1 | Kafshët e gjalla | Të gjitha kafshët e kapitullit 1 të për-dorura janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 2 | Mishi dhe të brëndëshmet e ngrë-nëshme të mishit | Prodhime në të cilat të gjitha materia-let e Kapitujve 1 dhe 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 3 | Peshku e kafshët guackore të nenujëshme, molusqet e kafshët e tjera jovertebrore ujore | Prodhime në të cilat të gjitha materia-let e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| Ex Kapitulli 4 | Produktet bulmetore; vezet e zogjve; mjalte natyral; produkte të ngrenshme me origjine prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër, përveç: | Prodhime në të cilat të gjitha materia-let e Kapitullit 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 0403 | Dhalle, qumesht e krem i prerë, kos, kefir e qumësht e krem tjetër të fermentuara ose të acidifikuara, nëse janë ose jo të koncentruara ose që përmbajnë sheqer shtesë ose lëndë të tjera ëmbëlsuese ose lëndë aromatizuese ose që për-mbajnë fruta, arra ose kakao shtesë | Prodhime në të cilat :<br>- Të gjitha materialet e Kapitullit 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese<br>- Të gjitha lëngjet e frutave (përjashtuar ato të ananasit, qitros ose greipfrutit) të kreut 2009 të përdorur janë origjinuese<br>- vlera e çdo materiali të përdorur të Kapitullit 17 nuk kalon vleren prej 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| Ex Kapitulli 5<br><br>ex 0502 | Produktet me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; përveç<br><br>Qime dhe lesh të derrave të përgatitur, derrave të tredhur ose derrave të egër | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 5 të përdorur janë tërësisht origjinuese<br><br>Pastrimi, disifektimi, ndarja dhe drejtimi i qimeve dhe leshit | |
| Kapitulli 6 | Pemët dhe bimët e tjera, të gjalla; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashmet me to; lulet e prera dhe gjethnajat zbukuruese | Prodhime në të cilat :<br><br>- të gjitha materialet e Kapitullit 6 të përdorur janë tërësisht origjinuese<br><br>- vlera e çdo materiali të përdorur nuk kalon vleren prej 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 7 | Zarzavatet e ngrënëshme dhe rrenjet dhe tuberat perkates | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 7 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 8 | Frutat dhe arrat e ngrënëshme; lëkurat e agrumeve ose të pjeprave | Prodhime në të cilat :<br><br>- të gjitha frutat dhe arrat të përdorur janë tërësisht origjinuese<br><br>- vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon vleren prej 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 9<br><br>0901<br><br>0902<br><br>ex 0910 | Kafe, çaj, mate dhe erëza, përveç:<br><br>Kafe, nëse është ose jo e pjekur ose e dekafezuar; lëvoret e lëkurat e kafesë; zëvëndësuesit e kafesë që përmbajnë kafe në çdo porcion<br><br>Çaj, nëse është ose jo i aromatizuar<br><br>Përzierje të erëxave | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 9 të përdorur janë tërësisht origjinuese<br><br>Prodhime prej materialeve të çdo kreu<br><br>Prodhime prej materialeve të çdo kreu<br><br>Prodhime prej materialeve të çdo kreu | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| Kapitulli 10 | Drithërat | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 10 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; malt; niseshtetë; inuline; gluteni i grurit, përveç | Prodhime në të cilat të gjitha drithrat, zarzavatet e ngrënëshme, rrënjët e tuberat e Kreut 0714 ose fruta të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 1106 | Miell, kokrriza e pluhur i zarzavateve të thara leguminoze të kreut Nr. 0713 | Tharja dhe bluarja e zarzavadeve leguminoze të kreut 0708 | |
| Kapitulli 12 | Farat vajore e frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara e fruta të përziera; bimët industriale ose medicinale; kashta e tagjia | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 12 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1301 | Lac; gomë natyrale, rrëshirat, gomërrëshirat e oleo-rrëshirat (për shëmbull, balsamet) | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të kreut 1301 të përdorur nuk mund të kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 1302 | Lëngje e ekstrakte vegjetale; substanca pektike, pektinatet e pektatet; agar-agar e lëndë të tjera ngjitëse e trashëse, nëse janë ose jo të modifikuara, të rrjedhura nga produktet vegjetale : | | |
| | - Ngjitësa dhe trashësa, të modifikuara ose të rrjedhura nga produktet vegjetale | Prodhime nga ngjitësat dhe trashësat e pamodifikuar | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat vlera të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 14 | Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime në të cilat të gjitha materialet të Kapitullit 14 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| ex Kapitulli 15 | Vajra e dhjamra prej kafshëve ose vegjetale e produktet e ndarjes së tyre; yndyrna të përgatitura të ngrënëshme; dyllët prej kafshëve ose vegjetale, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 1501 | Dhjam derri (përfshirë sallon) e dhjami i shpendëve, ndryshe nga ai i kreut 0209 ose 1503 : | | |
| | - Dhjamra prej kockave ose mbetjeve | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të krerëve 0203, 0206 ose 0207 ose kockave të kreut 0506 | |
| | - Të tjera | Prodhime prej mishi ose të brëndshmeve të ngrënëshme të derrit të kreut 0203 ose 0206 ose mishit ose të brendshmeve të ngrënshme të shpendëve të kreut 0207 | |
| 1502 | Dhjami i gjedhëve, deleve ose dhive, ndryshe nga ato të kreut 1503 | | |
| | - Dhjamra prej kockave ose mbetjeve | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të krerëve 0201, 0202, 0204 ose 0206 ose kockave të kreut 0506 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1504 | Dhjamra e vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut ose të sisorëve detare, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht : | | |
| | - Fraksione solide | Prodhime nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1504 | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur duhet të jenë tërësisht origjinuese | |
| ex 1505 | Lanolin e rafinuar | Prodhime prej vajrave të leshit të papërpunuar të kreut 1505 | |
| 1506 | Dhjamra e vajra të tjera me origjinë prej kafshëve e fraksionet e tyre, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht : | | |
| | - Fraksione solide | Prodhime nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1506 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1507 deri 1515 | Vajra vegjetale e fraksionet e tij : | | |
| | - Soje, kikiriku, palme, kopre, thelb palme, babasu, vaj tungu e oitika, dyllë mersine e japonez, fraksionet e vajit të jajobës e vajra për përdorime teknike e industriale të ndryshme nga prodhimet e ushqimit për konsum njerëzor | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| | - Fraksionet solide, përjashtuar ato të vajit jajoba | Prodhime prej materialeve të tjera të kreut 1507 deri 1515 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 1516 | Yndyrna me origjinë prej kafshëve ose vegjetale dhe vajra dhe fraksionet e tyre, tërësisht ose pjesërisht të hidrogjenizuara, të interesterifikuara, të riesterifikuara ose të elaidinifikuara, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo më tej të përgatitura | Prodhime në të cilat :<br>- të gjitha materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese<br>- të gjithë materialet vegjetale të përdorur janë tërësisht origjinuese. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 1517 | Margarinë; përzierjet ose përgatitjet e ngrënëshme të vajrave e dhjamrave vegjetale ose prej kafshëve ose vajra ose të fraksioneve të yndyrnave ose vajrave të ndryshme të këtij Kapitulli, të ndryshme nga yndyrnat ose vajrat e ngrënshme ose të fraksioneve të tyre të kreut 1516 | Prodhime në të cilat :<br><br>- të gjitha materialet e Kapitullit 2 dhe 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese<br><br>- të gjithë materialet bimore të përdorur janë tërësisht origjinuese. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren | |
| Kapitulli 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut ose prej krustaceve, prej molusqeve ose prej kafshëve të tjera jovertebrore ujore | Prodhime:<br><br>- prej kafshëve të Kapitullit 1, dhe/ose<br><br>- në të cilët të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej sheqeri, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 1701 | Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose nga panxhar sheqeri e saharoza kimikisht e pastër, në gjëndje të ngurtë, të aromatizuar ose lëndë ngjyruese | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 1702 | Sheqerëra të tjera, përfshirë laktozen, maltozen, glukozen e fruktozen kimikisht të pastra, në gjëndje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese e ngjyruese shtesë; mjaltë artificial, nëse është ose jo i përzier me mjaltë natyral; karamel : | | |
| | - Maltoza dhe fruktoza të pastra kimikisht | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përfshirë materiale të tjera të kreut 1702 | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| | - Sheqerëra të tjera në forma të ngurta, të aromatizuara ose të ngjyrosura | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e përdorur janë origjinuese | |
| ex 1703 | Melasat e rezultuara nga eks-tragimi ose rafinimi i sheqerit, të aromatizuara ose të ngjyrosura | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 1704 | Embëlsirat prej sheqerit (përfshirë çokollatën e bardhë), që nuk përmbajnë kakao | Prodhime:<br>- prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit, dhe<br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon<br>30% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 18 | Kakao e përgatitjet prej kakaos | Prodhime:<br>- prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit , dhe<br>- në të cilat vlera e çdo materiali te<br>Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon<br>30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 1901 | Ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtesë ose ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë kakao ndaj peshës me pak së 40% të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të paspecifikuara e të papërfshira diku tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krerëve Nr.0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë kakao ndaj peshës më pak së 5 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | | |
| | - Ekstrakt malti | Prodhime prej drithrave të Kapitullit 10 | |
| | - Të tjera | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit , dhe<br><br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 1902 | Brumrat, nëse janë ose jo të gatuar ose të mbushur (me mish ose me substanca të tjera) ose të përgatitur ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona petë, lasanje, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nëse janë ose jo të përgatitur : | | |
| | - Me përmbajtje 20% ose me pak sipas peshës të mishit, të brëndësmeve të mishit, peshkut, krustanceve ose molusqeve | Prodhime në të cilat të gjithë drithrat e nënproduktet e tyre (përjashtuar miellin durum e nënproduktet e tij) të përdorur janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| | - Me përmbajtje më shumë se 20% sipas peshës të mishit, të brëndëshmeve të mishit, peshkut, krustanceve ose molusqeve | Prodhime në të cilat :<br><br>- të gjitha drithrat dhe nënproduktet (përveç miellit durum dhe nënproduk-teve të tij) të përdorura janë tërësisht origjinuese, dhe<br><br>- të gjitha materialet e Kapitullit 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1903 | Tapioka e zëvëndësuesit e tij përgatitur nga niseshteja, në formën e fetëzave, kokrrave, margaritarëve, topthash ose në forma të ngjashme | Prodhime prej materialeve të çdo kapitulli, përveç nisështësë së patates të kreut 1108 | |
| 1904 | Ushqimet e përgatitura fituar prej bymimit ose pjekjes së drithrave ose të produkteve të tyre (p.sh. fetëza drithi); drithrat (ndryshe nga misri (si drith)) në formë kokrre ose në formë fetëzash ose kokrra të punuara ndryshe (për-veç miellit e kokrrizave të miellit), të paragatuara ose të për-gatitura ndryshe, të papërfshira ose të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime :<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atyre të kreut 1806,<br><br>- në të cilat të gjithë drithrat e miellrat (përveç miellit durum e nënproduktve të tij e misrit *zea indurata*) të përdorur janë tërësisht origjinuese, dhe<br><br>- në të cilën vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 1905 | Bukë, torta, kek, biskota e produkte të tjera të furrëtarit, nëse përmbajnë ose jo kakao; nafore, hapet (kapsulat) bosh të një lloji të përshtatshëm për qellime far-maceutike, vaferet me shtresa, letër orizi e produkte të ngjashme | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të Kapitullit 11 | |
| ex Kapitulli 20 | Përgatitje prej zarzavateve, fruta-ve, arrave ose pjesëve të tjera të bimëve, përveç : | Prodhime në të cilat të gjithë frutat, arrat ose zarzavatet e përdorura janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| ex 2001 | Yams, panxhar e pjesë të tjera të ngrënëshme të ngjashme të bimëve, me përmbajtje 5% ose më shumë sipas peshës të niseshtesë, të përgatitura ose të ruajtura në uthull ose në acid acetic | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit | |
| ex 2004 dhe 2005 | Patate në formë mielli, mielli të trashë ose ciflash, të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga në uthull ose në acid acetik | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit | |
| 2006 | Zarzavate, fruta, arra, lëkura frutash e pjesë të tjera të bimëve, të ruajtura në sheqer (të thara, të sheqerosura ose të kristalizuara) | Prodhime në të cilën vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 2007 | Reçelet, peltet e frutave, marmalatat, pure frutash ose arrash e brum frutash ose arra, që janë për-gatitje të gatuara, nëse përmbajnë ose jo sheqer ose lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë | Prodhime:<br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe<br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 2008 | - Arra, që nuk përmbajnë sheqer ose aromatikë shtesë | Prodhime në të cilat vlera e arrave dhe vajrave bimore origjinuese të kreut 0801, 0802 dhe 1202 deri 1207 të përdorur e kalon 60% të çmimit ex-works të produktit | |
| | - Gjalp kikiriku; përzierje të bazuara në drithra; zemra palme; misër (drith) | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| | - Të tjera, përveç frutave dhe arrave të gatura ndryshe nga me avull ose vlim me ujë, duke mos për-mbajtur sheqer shtesë, të ngrira | Prodhime:<br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe<br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 2009 | Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) e lëngje zarzavatesh, të pafermentuara e që nuk përm-bajnë lëndë alkoolike shtesë, nëse përmbajnë sheqer ose lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe<br><br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 21 | Përgatitje të ndryshme të ngrënëshme, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 2101 | Ekstrakte, esenca e konçentrate, të kafesë, çajit ose matesë dhe përgatitjet me bazë të këtyre pro-dukteve ose me bazë të kafesë, çajit ose matesë; çikore e pjekur e zëvëndësuesit e tjerë të pjekur të kafesë, dhe ekstraktet, esencat dhe konçentratet prej tyre | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe<br><br>- në të cilat të gjitha çikoret e përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 2103 | Salcat e përgatitjet prej tyre; erëza të përziera e aromatizues të përzi-er; miell e kokrriza mielli mustar-de e mustarde të përgatitur : | | |
| | - Salcat e përgatitjet prej tyre; erëza të përziera e aromatizues të përzierë | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit . Megjithatë miell e kokrriza mielli mustardë dhe mustardë e përgatitur mund të përdoren | |
| | - Miell mustarde dhe ushqim dhe mustardë e përgatitur | Prodhime prej materiale të çdo kreu | |
| ex 2104 | Supat e lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre | Prodhime prej materiale të çdo kreu përveç zarzvateve të përgatitura ose të ruajtura të kreut 2002 deri 2005 | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 2106 | Përgatitje ushqimore të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe<br><br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 22 | Pijet, alkoolet dhe uthullat; përveç : | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit,<br><br>- në të cilat i gjithë rrushi ose çdo nënprodukt rrushi i përdorur janë origjinuese | |
| 2202 | Ujrat, përfshirë ujrat minerale e ujrat e gazuar, që përmbajnë sheqer ose lëndë të tjera ëmbëlsuese ose aromatizuese, shtesë, e pije të tjera jo-alkoolike, pa përfshirë lëngun e frutave ose të zarzavateve të kreut Nr. 2009 | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit,<br><br>- në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit, dhe<br><br>- në të cilat çdo lëng frutash të përdorur (përveç lëngjeve të ananasit, qitros dhe greit-frutit) janë origjinuese | |
| 2207 | Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% vol ose më e lartë; alkool etilik e alkoole të tjera, të denatyruara, të çdo lloj force | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208, dhe<br><br>- në të cilët i gjithë rrushi ose nënprodukt nga rrushi të përdorur janë tërësisht origjinues ose nëqoftëse të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkolike mund të perdoren në një kufi deri 5% sipas volumit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 2208 | Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak së 80 % vol; pije alkooli-ke, likere e alkoole të tjera | Prodhime:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208, dhe<br><br>- në të cilët i gjithë rrushi ose nënpro-dukt nga rrushi të përdorur janë tërë-sisht origjinues ose nëqoftëse të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkoolike mund të përdoren në një kufi deri 5% sipas volumit | |
| ex Kapitulli 23 | Mbetjet e kthimet nga industritë ushqimore; tagjia e përgatitur për kafshët; përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 2301 | Ushqim balene, miell, ushqim dhe toptha prej peshku ose krustacesh, molusqesh e kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të papërshtat-shme për konsum njerëzor | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 2303 | Mbetjet prej prodhimeve të nise-shtesë së mistrit (përjashtuar lën-gjet e konçentruar së tepërmi), me përmbajtje proteine të llogaritur ndaj produktit të thatë që kalon 40% ndaj peshës. | Prodhime në të cilat të gjitha misrat e përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 2306 | Vaj i trashë dhe mbetje të tjera të forta, përfituar nga përpunimi i vajit të ullirit, që përmban më shumë se 3% vaj ulliri. | Prodhime në të cilat të gjithë ullinjtë e përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 2309 | Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafshëve | Prodhime në të cilat :<br><br>- të gjithë drithrat, sheqeri ose mala-sat, mishi ose qumështi i përdorur janë tashmë origjinuese, dhe<br><br>- të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 9030 | Oshiloskopet, analizatoret spektrum e aparate e instrumenta të tjerë për matjen ose kontrollin e madhesive elektrike, perjashto matesit e kreut Nr. 9028; instrumentat e aparatet për matjen ose detektimin e rrezatimeve alfa, beta, gama, rreze X, rrezatimeve kozmike ose jonizuese të tjera | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9031 | Instrumentat mates ose kontrollues, pajisje e makina, jo të specifikuara ose të pa perfshira diku tjetër në kete Kapitull; projektoret e profilit | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9032 | Instrumenta e aparate të rregullimit ose kontrollit automatik | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9033 | Pjesët e plotesuesit (jo të specifikuara ose të pa perfshira diku tjetër në kete Kapitull) për makinerite, pajisjet, instrumentat ose aparatet e Kapitullit 90 | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 91 | Oret e të gjitha llojeve e pjesët e tyre; përveç: | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9105 | Ore të tjera | Prodhim në të cilat:<br>- vlera e të gjitha materialeve të perdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit , dhe<br>- kur vlera e të gjitha materialeve jo origjinuese të përdorur nuk kalon vleren e materialeve origjinuese të përdorur | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 9109 | Levizesit e ores së murit, komplet dhe të montuara | Prodhim në të cilat :<br><br>- vlera e të gjitha materialev-e të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit , dhe<br><br>- vlera e të gjitha materialeve jo origjinuese të përdorur nuk kalon vleren e materialeve origjinuese të përdorur | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit |
| 9110 | Levizesit komplet të oreve të dores ose të murit, të pamontuara ose pjesërisht të montuara (grup levizjet); levizesit jokomplete të oreve të murit ose të dores, të montuara; levizesit e paperpunuara të oreve të dores ose të murit | Prodhim në të cilat:<br><br>- vlera e të gjitha materialeve të perdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit , dhe<br><br>- brenda kufirit të siperm, vlera e të gjitha materialeve të kreut 9114 të përdorur nuk kalon vleren 10% të çmimit ex-works të produktit | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit |
| 9111 | Kasat e oreve të dores e pjesët e tyre | Prodhim:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe<br><br>- në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit |
| 9112 | Kasat e oreve të murit e kasat e një tipi të ngjashem për mallrat e tjerë të këtij Kapitulli, e pjesët e tyre | Prodhim:<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe<br><br>- në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit |
| 9113 | Rripat e oreve të dores, bandat e oreve të dores e byzylyqe ore, e pjesët e tyre : | | |
| | - Me bazë metali, nëse është ose jo i lare me ar ose argjend, ose metal të mbeshtjellur me metal të çmuar | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| | - Të tjera | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 92 | Instrumentat muzikore; pjesët dhe plotesuesit e artikujve të tille | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 93 | Armet dhe municionet; pjesët dhe plotesuesit e tyre | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 94<br><br>ex 9401 dhe ex 9403 | Mobilerite; krevatet, dysheket, mbajteset e dyshekeve, jasteqet e shtresa të ngjashme të mbushura; llampat e pajime ndricimi, jo të perfshira ose të specifikuara diku tjetër; shenjat ndricuese, pllakat e emrit ndricuese dhe të ngjashmet e tyre; ndertesat e parafabrikuara; përveç :<br><br>Mobilje me bazë metali, të perfshira me materiale cope pambuku me një peshe prej 300 g/m² ose më shumë | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit<br><br>Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , ose<br><br>Prodhim prej copa pambuku tashme të bera në formë të gateshme për per-dorim në kreun 9401 ose 9403, me kusht që :<br><br>- vlera e tyre nuk kalon 25% të çmimit ex-works të produktit , dhe<br><br>- të gjitha materialet e tjera të përdorur janë origjinuese e janë klasifikuar në një kre të ndryshëm nga ai 9401 ose 9403 | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit<br><br>Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 9405 | Llampat e paisje ndricuese perfshire projektoret e ndricuesit projektore e pjesët e tyre, të papërfshirë e të paspecifikuar diku tjetër; shenjat ndricuese, pllakat e emrit ndricuese e të ngjashmet e tyre, të cilet kane një burim drite të fiksuar të perhershem, e pjesët e tyre të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9406 | Ndertesa të parafabrikuara | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 95 | Lodrat, pajisjet e lojrave dhe ato sportive; pjesët dhe plotesuesit e tyre; përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 9503 | Lodra të tjera; modele me permasa ("shkalle") të zvogeluara e modele të rikrijuara të ngjashem, që punojne ose jo; rebuset e të gjitha llojeve | Prodhim:<br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe<br>- në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 9506 | Shkopinjte e golfit dhe pjesët e tyre | Prodhim në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, blloqe në forma të forta për prodhimin e kokave të shkopinjve të golfit mund të përdoren | |
| ex Kapitulli 96 | Artikujt të ndryshëm të prodhuar; përjashtuar me : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 9601 dhe ex 9602 | Artikuj të gdhendur prej materiale kafshesh, zarzavatesh ose mineralesh | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| ex 9603 | Fshesat, furcat (përveç prej shqope e si këto), fshiresit e dyshemese mekanike për të operuar me dore, të pa motorizuara; fshiresit e pluhurave me pende e ato me fitila; xhufkat e nyjet | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9605 | Grup mallrash për udhetime, të përdorura për tualet personal, për qepje ose për pastrimin e kepuceve ose të rrobave | Çdo njesi në kete asortiment duhet të kenaqe rregullin i cili do të aplikohet në kete rast nëse ai nuk do të ishte përfshirë në kete asortiment. Megjithatë, artikujt jo origjinues mund të trupezohen por vlera totale tyre nuk kalon 15% të çmimit ex-works të asortimentit. | |
| 9606 | Butonat, mberthyesit me shtypje, sustat e komcat, format e butonave e pjesë të tjera të këtyre artikujve; vrimat e butonave | Prodhim :<br><br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe<br><br>- në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9608 | Penat me maje të rrumbullaket; penat e shenuesit me maje të mbushur e të tjerë me maje poroze; stilografat, penatstilograf e pena të tjera; lapsat kopjative; lapsat rreshqites; mbajtesit e lapsave e stilolapsave e mbajtes të ngjashem; pjesët (përfshirë kappaket e kapesit) e artikujve të siperpershkruar, përveç atyre të kreut Nr.9609 | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit Megjithatë majat e penes dhe majatpike të penes të klasifikuara në të njejtin kre me ate të produktit mund të përdoren | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinues, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---|---|---|---|
| (1) | (2) | (3) or | (4) |
| 9612 | Shiritat për makinat e shkrimit ose shirita të ngjashem, të bojatisur ose të përgatitur ndryshe për dhenien e impresioneve, nëse janë ose jo në rotka ose në bobina; tamponet e bojes, nëse janë ose jo me boje, me ose pa kuti | Prodhim :<br>- prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe<br>- në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 9613 | Çakmaket me ndezez piezoelektrik | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të kreut 9613 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 9614 | Çibuqet dhe llullat | Prodhim prej blloqe në forma të forta | |
| Kapitulli 97 | Veprat e artit, copat e mbledhura nga koleksionistet dhe antikat | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |

**SHTOJCA III**

MODELE PER ÇERTIFIKATEN E QARKULLIMIT TË MALLRAVE EUR.1 DHE APLIKIMI PER NJE ÇERTIFIKATE LEVIZJEJE EUR.1

Udhezime për shtypjen e formularit të aplikimit

1. Secili formular duhet te kete permasa 210 x 297 mm, eshte e pranueshme 5 mm me pak ose 8 mm me shume gjatesi eshte e lejueshme. Letra e perdorur duhet te jete e bardhe, e madhesise per shkrim, te mos permbaje material letre mekanik dhe pesha te mos jete nen 25 g\m2. Ajo duhet të në sfond një model të shtypur në ngjyrë të gjelbër duke e bërë të dallueshme me sy cdo lloj falsifikimi me mjete kimike ose mekanike.

2. Autoritete kompetente të Shteteve Anëtare të Komunitetit dhe të Shqipërisë mund të kenë të drejtën për të shtypur vetë këta formularë ose mund të shtypen për ta nga printera të aprovuar. Në rastin e fundit, cdo formular duhet të përfshijë një rekomandim për një miratim të tillë. Secili formular duhet të mbajë emrin dhe adresën e printerit ose një shenjë dalluese me anë të së cilës mund të identifikohet. Ajo duhet të ketë gjithashtu një numër serie, të shtypur ose jo, prej së cilës mund të identifikohet.

ÇERTIFIKATË E QARKULLIMIT TË MALLRAVE

<table>
<tr><td rowspan="3">1. Eksportuesi (Emër, adresa e plotë, shteti)</td><td colspan="2">EUR.1 Nr. A 000.000</td></tr>
<tr><td colspan="2">Para se të plotesohet formulari shih shënimet e bëra në pjesën e pasme të tij.</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">2. Çertifikata përdoret për tregtimin preferencial midis<br><br>.............................................................<br><br>Dhe<br><br>………………………………………<br><br>(Vendos shteti, grupin e shteteve ose territorin e përkatës)</td></tr>
<tr><td rowspan="2">3. Marrësi i ngarkesës (Emri, adresa e plotë, shteti) (Fakultativ)</td></tr>
<tr><td>4. Shteti, shtetet ose territori të cilët konsiderohen si origjina e mallit</td><td>5. Shteti, shtetet ose territori të cilët janë destinacioni</td></tr>
<tr><td>6. Detajet e transportimit (Fakultativ)</td><td colspan="2">7. Vërejtjet</td></tr>
<tr><td>8. Numri i artikujve; Marka dhe numrat; Numri dhe lloji i paketimit[1]; Përshkrimi i mallit</td><td>9. Pesha bruto (kg) ose njësi të tjera mase (litër, $m^3$,</td><td>10. Faturat (Fakultativ)</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | etj.) | |
| 11. Nënshkrimi i doganës<br><br>Deklara e vërtetuar<br><br>Dokumenti eksportimit²<br><br>Formulari………………<br>Nr ……….<br><br>Nga …………………………………<br><br>Zyra e doganës …………………….<br><br>Shteti ose territori që bën lëshimin<br><br>………………………………………<br>Vula<br><br>………………………………………<br><br>Vendi dhe data …………………….<br><br>………………………………………<br><br>(Firma) | 12. DEKLARATA NGA EKSPORTUESI<br><br>Unë, nënshkruesi, deklaroj se mallrat e përshkruara më sipër i përmbushin kushtet e kërkuara për lëshimin e kësaj certifikate.<br><br>Vendi dhe data …………………………<br><br>………………………………………….<br><br>(Firma) | |
| | | |

| | |
|---|---|
| 13. KERKESE PER VERIFIKIM, ndaj | 14. REZULTATI I VERIFIKIMIT |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>Verifikimet e kryera treguan që kjo çertifikatë[1]<br><br>□ ishte lëshuar nga zyra doganore të përcaktuara dhe që informacioni që përmbahej aty ishte i saktë.<br><br>□ Nuk plotëson kërkesat si vërtetësia dhe saktësia (shih shënimet bashkangjitur).<br><br>…………………………………………………………………<br><br>( Vendi dhe data )<br><br>Vula<br><br>…………………………………………..<br><br>( Firma )<br><br>___________<br>(1) vendos X në kutinë e duhur</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| Kërkohet verifikimi i vërtetësisë dhe saktësisë të kësaj certificate<br><br>……………………………………………………………<br><br>( Vendi dhe data )<br><br>Vula<br><br>…………………………………..<br><br>( Nënshkruesi ) | |

[1] Nëse mallrat nuk janë të paketuara, tregoni numrin e artikujve dhe gjendjen

[2] Të plotësohet vetëm nëse e kërkon nga vendi ose territori që e eksporton

SHËNIME

1. Çertifikata nuk duhet të përmbaje vende të fshira apo fjalë të shkruara njëra mbi tjetrën. Çdo modifikim duhet të bëhet duke fshirë të dhënat e gabuara dhe duke shtuar çdo korrigjim të nevojshëm. Çdo modifikim i tillë duhet të fillohet nga personi i cili e ka plotësuar çertifikatën dhe të nënshkruhet nga autoritetet doganore të vendit apo territorit që e ka lëshuar.

2. Nuk duhet të ketë asnjë hapësirë midis fjalive që shkruhen në çertifikatë dhe çdo pikë duhet të paraprihet nga një numër përkatës. Duhet te hiqet një vizë horizontale menjëherë poshtë fjalisë së fundit. Në cdo hapësirë të papërdorur duhet të hiqen viza të tjera në një mënyrë të tillë që çdo shtesë të jetë e pamundur për tu bërë.

3. Mallrat duhet të përshkruhen në përputhje me praktikën tregtare dhe me detaje të mjaftueshme, që të jetë e mundur identifikimi i tyre.

Teksti i deklarates se fatures

Deklarata a fatures, teksti te ciles eshte dhene me poshte, duhet te behet ne perputhje me shënimet e bëra. Megjithate, nuk eshte e nevojshme që shënimet te riprodhohen.

Versioni Spanjoll

El exportador de los productos incluidos en el presente documento (autorización aduanera n° ...[i]) declara que, salvo indicación en sentido contrario, estos productos gozan de un origen preferencial ...[ii].

Versioni Çek

Vývozce výrobků uvedených v tomto dokumentu (číslo povolení …[1]) prohlašuje, že kromě zřetelně označených, mají tyto výrobky preferenční původ v …[2].

Versioni Danez

Eksportøren af varer, der er omfattet af nærværende dokument, (toldmyndighedernes tilladelse nr. ...[1]), erklærer, at varerne, medmindre andet tydeligt er angivet, har præferenceoprindelse i ...[2].

Versioni Gjerman

Der Ausführer (Ermächtigter Ausführer; Beëilligungs-Nr. ...[1]) der Ëaren, auf die sich dieses Handelspapier bezieht, erklärt, dass diese Ëaren, soëeit nicht anderes angegeben, präferenzbegünstigte ...[2] Ursprungsëaren sind.

Versioni Estonez

Käesoleva dokumendiga hõlmatud toodete eksportija (tolliameti kinnitus nr. ...[(1)]) deklareerib, et need tooted on ...[(2)] sooduspäritoluga, välja arvatud juhul kui on selgelt näidatud teisiti.

Versioni Grek

Ο εξαγωγέας των προϊόντων που καλύπτονται από το παρόν έγγραφο (άδεια τελωνείου υπ΄αριθ. ...[(1)]) δηλώνει ότι, εκτός εάν δηλώνεται σαφώς άλλως, τα προϊόντα αυτά είναι προτιμησιακής καταγωγής ...[(2)].

Versioni Anglez

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No ...[(1)]) declares that, except ëhere otherëise clearly indicated, these products are of ...[(2)] preferential origin.

Versioni Francez

L'exportateur des produits couverts par le présent document (autorisation douanière n° ...[(1)]) déclare que, sauf indication claire du contraire, ces produits ont l'origine préférentielle ... [(2)]).

Versioni Italian

L'esportatore delle merci contemplate nel presente documento (autorizzazione doganale n. ...[(1)]) dichiara che, salvo indicazione contraria, le merci sono di origine preferenziale ...[(2)].

Versioni Letonez

Eksportētājs produktiem, kuri ietverti šajā dokumentā (muitas pilnvara Nr. …[(1)]), deklarē, ka, iznemot tur, kur ir citādi skaidri noteikts, šiem produktiem ir priekšrocību izcelsme no …[(2)].

Versioni Lituanez

Šiame dokumente išvardintų prekių eksportuotojas (muitinės liudijimo Nr …[1]) deklaruoja, kad, jeigu kitaip nenurodyta, tai yra …[2] preferencinės kilmės prekės.

Versioni Hungarez

A jelen okmányban szereplő áruk exportőre (vámfelhatalmazási szám: …[1]) kijelentem, hogy eltérő jelzés hianyában az áruk kedvezményes …[2] származásúak.

Versioni Maltez

L-esportatur tal-prodotti koperti b'dan id-dokument (aëtorizzazzjoni tad-dëana nru. …[1]) jiddikjara li, ħlief fejn indikat b'mod ċar li mhux hekk, daën il-prodotti huma ta' oriġini preferenzjali …[2].

Versioni Hollandez

De exporteur van de goederen ëaarop dit document van toepassing is (douanevergunning nr. ...[1]), verklaart dat, behoudens uitdrukkelijke andersluidende vermelding, deze goederen van preferentiële ... oorsprong zijn [2].

Versioni Polak

Eksporter produktóë objętych tym dokumentem (upoëażnienie ëładz celnych nr …[1]) deklaruje, że z ëyjątkiem gdzie jest to ëyraźnie określone, produkty te mają …[2] preferencyjne pochodzenie.

Versioni Portugez

O abaixo assinado, exportador dos produtos cobertos pelo presente documento (autorização aduaneira n°. ...[1]), declara que, salvo expressamente indicado em contrário, estes produtos são de origem preferencial ...[2].

Versioni Slloven

Izvoznik blaga, zajetega s tem dokumentom (pooblastilo carinskih organov št …[1]) izjavlja, da, razen če ni drugače jasno navedeno, ima to blago preferencialno …[2] poreklo.

Versioni Sllovak

Vývozca výrobkov uvedených v tomto dokumente (číslo povolenia …[1]) vyhlasuje, že okrem zreteľne označených, majú tieto výrobky preferenčný pôvod v …[2].

Versioni Finlandez

Tässä asiakirjassa mainittujen tuotteiden viejä (tullin lupa n:o ...[1]) ilmoittaa, että nämä tuotteet ovat, ellei toisin ole selvästi merkitty, etuuskohteluun oikeutettuja ... alkuperätuotteita [2].

Versioni Suedez

Exportören av de varor som omfattas av detta dokument (tullmyndighetens tillstånd nr. ...[1]) försäkrar att dessa varor, om inte annat tydligt markerats, har förmånsberättigande ... ursprung [2].

Versioni Shqiptar

Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizim doganor Nr. … [i]) deklaron që, përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë preferenciale ... [ii].

……………………………………………………………………………………………

*(iii)*

*(Vendi dhe data)*

……………………………………………………………………………………………

*(iv)*

*(Firma e eksportuesit, si edhe emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të paraqiten me gërma shtypi të qarta)*

(i) Kur lëshohet një faturë nga një eksportues i autorizuar, numri i autorizimit të eksportuesit me licence duhet të shenohet në vendin e caktuar për ketë e qëllim. Në rast se fatura nuk ëshë hartuar nga një eksportues i licencuar, fjalët në kllapa hiqen ose vendi lihet bosh.

(ii) Të tregohet origjina e produkteve. Kur fatura ka lidhje, plotësisht apo pjesërisht, me produktet që i përkasin Seutës dhe Melilës, eksportuesi duhet t'i përfshijë ato qartë në dokument, ku deklarata të tregohet me simbolin 'CM'.

(iii) Këto informacione mund të përjashtohen nëse tashmë janë të përfshira në document.

(iv) Në rastet kur eksportuesit nuk i kërkohet të firmosë, përjashtimi i firmës së tij do të nënkuptojë gjithashtu edhe përjashtimin e emrit të nënshkruesit\eksportuesit.

DEKLARATA NE LIDHJE ME PROTOKOLLIN 4

DEKLARATE E PERBASHKET

Ne lidhje me Principatën e Andorës

1. Prodhime që e kanë origjinën në Principatën e Andorës të Kapitullit 25 deri në 97 të Sistemit të Harmonizuar pranohen nga Shqipëria si të Komunitetit në përputhje me këtë Marreveshje.

2. Protokolli 4 do të zbatohet mutatis mutandis me qëllim që të përcaktohet statusi i origjinës së prodhimeve të sipër përmendur.

DEKLARATE E PERBASHKET

Ne lidhje me Republikën e San Marinos

1. Prodhime që e kanë origjinën në Republikësn e San Marinos pranohen nga Shqipëria si të Komunitetit në përputhje me thelbin e kësaj Marreveshjeje.

2. Protokolli 4 do të zbatohet mutatis mutandis për të përcaktuar statusin e origjinës së prodhimeve të sipër përmendur.

# PROTOKOLLI 5

# MBI NDIHMEN E NDERSJELLTE ADMINISTRATIVE

# NE ÇESHTJET DOGANORE

(MSA PROTOKOLL 6)

NENI 1

Përkufizimet

Për qëllime të këtij Protokolli:

(a) “legjislacioni doganor” do të nënkuptojë çdo dispozitë ligjore ose rregullatore të zbatueshme në territoret e Palëve Kontraktuese, që qeverisin importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave dhe vendosjen e tyre sipas çdo regjimi ose procedure tjetër doganore, duke përfshirë masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit;

(b) “autoriteti kërkues” do të nënkuptojë një autoritet administrativ kompetent, i cili është caktuar nga një Palë Kontraktuese për këtë qëllim dhe që bën një kërkesë për ndihmë në bazë të këtij Protokolli;

(c) “autoriteti i kërkuar’ do të nënkuptojë një autoritet administrativ kompetent i cili është caktuar nga një Palë Kontraktuese për këtë qëllim, dhe që merr një kërkesë për ndihmë në bazë të këtij Protokolli;

(d) “të dhëna personale” do të nënkuptojnë të gjithë informacionin në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm;

(e) “veprim në shkelje të legjislacionit doganor” do të nënkuptojë çdo shkelje ose orvatje për shkelje të legjislacionit doganor.

NENI 2

Fusha e veprimit

1. Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra tjetrën në fushat brënda kompetencave të tyre, në mënyrën dhe sipas kushteve të parashtruara në këtë Protokoll, për të siguruar zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor, veçanërisht duke parandaluar, hetuar dhe luftuar veprimet që shkelin atë legjislacioni.

2. Ndihma në çështjet doganore, siç parashikohet në këtë Protokoll, do të zbatohet ndaj çdo autoriteti administrativ të Palëve Kontraktuese, i cili është kompetent për zbatimin e këtij Protokolli. Ajo nuk do të cënojë rregullat që përcaktojnë ndihmën e ndërsjelltë në lidhje me çështjet penale. Gjithashtu, nuk do të mbulojë informacionin e përftuar nga kompetencat e ushtruara me kërkesë të autoritetit gjyqësor, përveçse kur komunikimi i këtij informacioni është autorizuar nga ai autoritet.

3. Ndihma për të kompensuar tatimet, taksat ose gjobat nuk mbulohet nga ky Protokoll.

NENI 3

Ndihma sipas kërkesës

1. Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, i cili mund t'i japë mundësinë autoriteti kërkues të sigurohet se legjislacioni doganor është zbatuar në mënyrën e duhur, duke përfshirë informacione në lidhje me aktivitetet e vërejtura ose të planifikuara që janë ose mund të jenë veprime në shkelje të legjislacionit doganor.

2. Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta informojë atë:

(a) nëse mallrat e eksportuara nga territori i njërës prej Palëve Kontraktuese janë importuar ashtu siç duhet në territorin e Palës tjetër, duke specifikuar sipas nevojës, procedurën doganore të zbatuar për mallrat;

(b) nëse mallrat e importuara në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese janë eksportuar ashtu siç duhet nga territori i Palës tjetër, duke specifikuar sipas nevojës, procedurën doganore të zbatuar për mallrat.

3. Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar , brënda kuadrit të dispozitave të tij ligjore ose rregullatore, do të marrë të gjithë hapat e nevojshme për të siguruar mbikqyrje speciale të:

(a) personave fizikë ose juridikë në lidhje me të cilët ka arsye të besohet se janë ose kanë qënë të përfshirë në veprime që shkelin legjislacionin doganor;

(b) vëndet ku stoqet e mallrave kanë qënë ose mund të mblidhen në mënyrë të tillë që ka arsye të besohet se synohet të përdoren në veprime që shkelin legjislacionin doganor;

(c) mjete transporti që përdoren ose mund të përdoren në mënyrë të tillë që ka arsye të besohet se synohen të përdoren në verpime që shkelin legjislacionin doganor.

NENI 4

Asistenca e paparashikuar

Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra tjetrën, me iniciativën e tyre dhe në përputhje me dispozitat e tyre ligjore ose rregullatore, nëse e konsiderojnë të nevojshme për zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor, veçanërisht duke siguruar informacion të përftuar në lidhje me:

- aktivitetet që janë ose kanë të ngjarë të jenë veprime në shkelje të legjislacionit doganor, dhe që mund të paraqesin interes për Palën tjetër Kontraktuese;
- -mjete ose metoda të tjera të përdorura për kryerjen e veprimeve në shkelje të legjislacionit doganor;
- -mallra të njohura që jenë objekt i veprimeve në shkelje të legjislacionit doganor;
- -persona fizikë ose juridikë në lidhje me të cilët ka arsye të besohet se janë ose kanë qënë të përfshirë për veprime në shkelje stë legjislacionit doganor;
- -mjete transporti në lidhje me të cilat ka arsye të besohet se kanë qënë, janë ose mund të përdoren për verpime në shkelje të legjislacionit doganor.

NENI 5

Dorëzimi, Njoftimi

Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullatore të zbatueshme për këtë të fundit, do të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që:

- të dorëzojë çdo dokument ose
- të njoftojë në lidhje me çdo vendim;

që buron nga autoriteti kërkues dhe që hyn brënda fushës së veprimit të këtij Protokolli, ndaj një marrësi që banon ose është vendosur në territorin e autoritetit të kërkuar.

Kërkesat për dërgimin e dokumentave ose njoftimin e vendimeve do të bëhen me shkrim në një gjuhë zyrtare  të autoritetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme për atë autoritet.

NENI 6

Forma dhe përmbajtja e kërkesave për ndihmë

1. Kërkesat, sipas këtij Protokolli, do të bëhen me shkrim. Ato do të shoqërohen nga dokumentat e nevojshme për të siguruar përputhshmëri me kërkesën. Kur kërkohen për shkak të urgjencës së situatës, mund të pranohen kërkesa gojore, megjithatë ato duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.

2. Sipas paragrafit 1, kërkesat do të përfshijnë informacionet e mëposhtme:

(a) autoritetin kërkues;

(b) masën e kërkuar

(c) objektin dhe arsyen e kërkesës;

(d) dispozitat ligjore ose rregullatore dhe elementë të tjerë ligjorë të përfshirë;

(e) të dhëna sa më të sakta dhe të plota në lidhje me personat fizikë ose juridikë, të cilët janë subjekt hetimi;

(f) një përmbledhje të fakteve përkatëse dhe të hetimeve të kryera.

3. Kërkesat do të dorëzohen në gjuhën zyrtare të autoritetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme për atë autoritet. Kjo kërkesë nuk do të zbatohet për dokumentat që shoqërojnë kërkesën sipas paragrafit 1.

4. Nëse një kërkesë nuk i përmbush kërkesat formale të parashtruara më sipër, mund të kërkohet korrigjimi ose përfundimi i saj; ndërkohë mund të urdhërohen masa parandaluese.

## NENI 7

### Ekzekutimi i kërkesave

1. Me qëllim që t'i përmbahet kërkesës për ndihmë, autoriteti i kërkuar do të procedojë, brënda kufijve të kompetencave të tij dhe burimeve në dispozicion, si të ishte duke vepruar në llogarinë e tij ose me kërkesë të autoriteteve të tjera të po asaj Pale Kontraktuese, duke dhënë informacion tashmë në zotërim, duke kryer hetimet e duhura ose duke u kujdesur për kryerjen e tyre. Kjo dispozitë do të zbatohet gjithashtu për çdo autoritet tjetër tek i cili është adresuar kërkesa nga autoriteti i kërkuar, kur ky i fundit nuk mund të veprojë vetë.

2. Kërkesat për ndihmë do të ekzekutohen në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullatore të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Zyrtarët e autorizuar të një Pale Kontraktuese, me aprovim të Palës tjetër Kontraktuese të përfshirë, dhe duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara nga kjo e fundit, mund të jenë të pranishëm për të përftuar në zyrat e autoritetit të kërkuar ose të çdo autoriteti tjetër të interesuar në përputhje me paragrafin 1, informacion në lidhje me aktivitetet që janë ose mund të jenë veprime në shkelje të legjislacionit doganor, për të cilat autoriteti i kërkuar ka nevojë, për qëllime të këtij Protokolli.

4. Zyrtarët e autorizuar të një Pale Kontraktuese të përfshirë, me aprovim të Palës tjetër Kontraktuese të përfshirë, dhe duke ju nënështruar kushteve të parashtruara nga kjo e fundit, mund të jenë të pranishëm në hetimet e kryera në territorin e kësaj të fundit.

## NENI 8

### Formulari në të cilin duhet komunikuar informacioni

1. Autoriteti i kërkuar do t'i komunikojë me shkrim rezultatet e hetimeve autoritetit kërkues, së bashku me dokumentat përkatëse, kopje të vërtetuara ose dokumenta të tjera.

2. Ky informacion mund të jetë i kompjuterizuar.

3. Dokumentat origjinale do të transmetohen, sipas kërkesës, vetëm në rastet kur kopjet e vërtetuara do të ishin të pamjaftueshme. Këto dokumenta origjinale do të kthehen në rastin më të parë.

NENI 9

Përjashtime për detyrimin për sigurimin e ndihmës

1. Ndihma mund të refuzohet ose mund të jetë subjekt ndaj përmbushjes së disa kushteve ose kërkesave në rastet kur një Palë është e mendimit se ndihma sipas këtij Protokolli:
   (a) ka të ngjarë të cënoni sovranitetin e Shqipërisë ose atë të një Shteti Anëtar, të cilit i është kërkuar të sigurojë ndihmë sipas këtij protokolli; ose
   (b) ka të ngjarë të cënoi politikën publike, sigurimin ose interesa të tjera thelbësore, veçanërisht në rastet e referuara sipas nenit 10 (2); ose
   (c) shkelin një sekret industrial, tregtar ose profesional.

2. Autoriteti i kërkuar mund ta shtyjë ndihmën bazuar në arsyen që ajo do të ndërhynte në hetimet, ndjekjen penale ose procedimin e mëtejshëm. Në këtë rast, autoriteti i kërkuar do të konsultohet me autoritetin kërkues për të vendosur nëse mund të jepet ndihma, duke qenë e nënshtruar ndaj këtyre kushteve, siç mund të kërkohet nga autoriteti i kërkuar.

3. Kur autoriteti kërkues kërkon ndihmë, të cilën do të ishte e pamundur ta siguronte vetë, këtë fakt do ta theksojë në kërkesën e tij. Më pas autoriteti i kërkuar do të vendosë si t'i përgjigjet kësaj kërkese.

4. Për rastet e referuara në paragrafët 1 dhe 2, vendimi i autoritetit të kërkuar dhe arsyet përkatëse duhet t'i komunikohen pa vonesë autoritetit kërkues.

NENI 10

Shkëmbimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme sipas këtij Protokolli do të jetë i një natyre konfidenciale ose të rezervuar, në varësi të rregullave të zbatueshme në secilën prej Palëve Kontraktuese. Ky do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë mbrojtjen që jepet për informacion të ngjashëm, sipas ligjeve përkatëse të Palës Kontraktuese që e ka marrë atë, dhe dispozitave korresponduese që zbatohen ndaj autoriteteve të Komunitetit.

2. Të dhënat personale mund të shkëmbehen vetëm kur Pala Kontraktuese, e cila mund t'i marrë ato, ndërmerr t'i mbrojë këto të dhëna në të paktën një mënyrë të barazvlefshme me mënyrën e zbatueshme për raste të veçantë për Palën Kontraktuese që i siguron këto të dhëna. Për këtë qëllim, Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra tjetrës informacion në lidhje me rregullat e tyre të zbatueshme, duke përfshirë sipas nevojës, dispozita ligjore në fuqi në Shtetet Anëtare të Komunitetit.

3. Përdorimi i informacionit të përftuar sipas këtij Protokolli, në procedimet gjyqësore ose administrative të filluara në lidhje me veprimet që shkelin legjislacionin doganor, konsiderohet të bëhet për qëllime të këtij Protokolli. Për këtë arsye, Palët Kontraktuese, në procesverbalet, raportet dhe dëshmitë e tyre e në procedimet dhe akuzat e paraqitura në gjyq, mund të përdorin si provë informacionin e përftuar dhe dokumentat e konsultura, në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli. Autoriteti kompetent që ka dhënë këtë informacion ose ka dhënë akses për ato dokumenta do të njoftohet në lidhje me këtë përdorim.

4. Informacioni i përftuar do të përdoret vetëm për qëllime të këtij Protokolli. Kur njëra prej Palëve Kontraktuese dëshiron të përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, ajo do të marrë miratim paraprak me shkrim nga autoriteti, i cili ka siguruar informacionin. Ky përdorim më pas do të jetë subjekt ndaj kufizimeve të parashtruara nga ai autoritet.

NENI 11

Ekspertët dhe dëshmitarët

Një zyrtar i një autoriteti të kërkuar mund të jetë i autorizuar të paraqitet, brënda kufijve të autorizimit të dhënë, si ekspert ose dëshmitar në procedimet gjyqësore ose administrative në lidhje me çështje të mbuluara nga ky Protokoll dhe të krijojë të tilla objekte, dokumenta ose kopje të vërtetuara, siç mund të nevojitet për procedimet. Kërkesa për paraqitje mund të tregojë specifikisht se para cilit autoritet gjyqësor ose administrativ, do të duhet të paraqitet zyrtari, dhe mbi cilat çështje e në bazë të cilës së drejtë ose kualifikimi, do të pyetet ai zyrtar.

NENI 12

Shpenzimet e ndihmës

Palët Kontraktuese do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet ndaj njëra tjetrës për rimbursimin e shpenzimeve të shkaktuara sipas këtij Protokolli, përveçse, për shpenzimet e bëra për ekspertët dhe dëshmitarët dhe për përkthyesit me shkrim dhe me gojë, të cilët nuk janë punonjës të shërbimit publik.

NENI 13

Zbatimi

1. Zbatimi i këtij Protokolli do t'i besohet nga njëra anë autoriteteve doganore të Shqipërisë dhe nga ana tjetër shërbimeve kompetente të Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare, si të shihet e arsyeshme. Ato do të vendosin në lidhje me të gjitha masat dhe rregullimet praktike të nevojshme për zbatimin e saj, duke marrë në konsideratë rregullat në fuqi, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Ato mund t'i rekomandojnë organeve kompetente amendime, që çmojnë se duhet t'i bëhen këtij Protokolli.

2. Palët Kontraktuese do të konsultohen me njëra tjetrën dhe më pas do të informojnë njëra tjetrën në lidhje me rregullat e detajuara të zbatimit, të cilat adoptohen në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli.

NENI 14

Marrëveshje të tjera

1. Duke marrë në konsideratë kompetencat përkatëse të Komunitetit Europian dhe të Shteteve Anëtare, dispozitat e këtij Protokolli:

   - nuk do të cënojnë detyrimet e Palëve Kontraktuese të përcaktuar sipas çdo marrëveshjeje apo konventash të tjera ndërkombëtare;

   - do të çmohen si plotësuese ndaj marrëveshjeve për ndihmë të ndërsjelltë, të cilat kanë qënë ose mund të lidhen midis Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë; dhe

- nuk do të cënojnë dispozitat e Komunitetit që përcaktojnë komunikimin midis shërbimeve kompetente të Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare për çdo informacion të përftuar sipas këtij Protokolli, i cili mund të ishte me interes për Komunitetin.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, dispozitat e këtij Protokolli do të kenë precedencë mbi dispozitat e çdo marrëveshjeje dypalëshe për ndihmë të ndërsjelltë, që ka qënë ose mund të lidhet midis Shteteve Anëtare dhe Shqipërise, në rastet kur dispozitat e kësaj të fundit nuk janë në përputhje me ato të këtij Protokolli.

3. Në lidhje me çështjet mbi zbatueshmërinë e këtij Protokolli, Palët Kontraktuese do të konsultohen me njëra tjetrën për ta zgjidhur çështjen në kuadër të Komitetit të Stabilizim Asociimit, të krijuar sipas nenit 120 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

AKTI PËRFUNDIMTAR

Të plotfuqishmit e:

KOMUNITETIT EUROPIAN,

referuar më poshtë si 'Komuniteti',

nga njëra anë, dhe

të plotfuqishmit e REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

nga ana tjetër,

mbledhur në Luksemburg më 12 qershor të vitit 2006 për nënshkrimin e Marrëveshjes së Përkohshme për tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar, ndërmjet Komuniteteve Europiane nga njëra anë, dhe Shqipërisë nga ana tjetër, referuar më poshtë si 'Marrëveshja e Përkohshme', miratuan tekstet e mëposhtme:

Marrëveshja e Përkohshme, Shtojcat e saj I deri ne IV, konkretisht:

- Shtojca I (Neni 6) – Koncesione Tarifore të Shqipërisë për prodhimet industriale të KE-së
- Shtojca II (Neni 14) – Koncesione Tarifore të Shqipërisë për prodhimet bujqësore të BE-së
- Shtojca III (Neni 15) – Koncesionet e KE-së për prodhimet e peshkimit shqiptar
- Shtojca IV (Neni 39) – Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, Industriale dhe Tregtare

dhe protokollet e mëposhtme:

- Protokolli 1 (Neni 10) – Prodhimet e hekurit dhe çelikut
- Protokolli 2 (Neni 12) – Tregtia me prodhimet bujqësore të përpunuara
- Protokolli 3 (Neni 14) – Prodhimet e verës dhe ato alkoolike
- Protokolli 4 (Neni 28) – Në lidhje me përkufizimin e konceptit të "prodhimeve nga vendi i origjinës" dhe metodat bashkëpunimit administrativ
- Protokolli 5 (Neni 42) –Ndihma e ndërsjellë administrative në çështjet e doganave.

Të plotfuqishmit e Komunitetit dhe të plotfuqishmit e Shqipërisë, miratuan tekstet e deklaratave të përbashkëta të renditura më poshtë dhe bashkëlidhur këtij Akti Përfundimtar:

Deklaratë e Përbashkët për nenet 9 dhe 16 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 28 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 39 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 49 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për Principatën e Andorës në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

Deklaratë e Përbashkët për Republikën e San Marinos në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

Të plotfuqishmit e Republikës së Shqipërisë morën parasysh Deklaratën e Komunitetit më poshtë dhe bashkëlidhur këtij Akti Përfundimtar:

Deklaratë e Komunitetit në lidhje me masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti në bazë të Rregullores (EC) No 2007/2000.

Nënshkruar në Luksemburg,

## DEKLARATAT E PËRBASHKËTA

### Deklaratë e përbashkët për nenet 9 dhe 16 të Marrëveshjes (MSA neni 22 dhe 29)

Palët deklarojnë se gjatë zbatimit të neneve 9 dhe 16 ata do të shqyrtojnë, në Këshillin e Stabilizim Asociimit, ndikimin e çdo marrëveshjeje preferenciale të negociuar nga Shqipëria me vendet e treta (me përjashtim të vendeve që mbulohen nga Procesi i Stabilizim Asociimit dhe vendet fqinjë të cilët nuk janë anëtare të BE-së). Ky shqyrtim do të mundësojë rregullimin e koncesioneve shqiptare dhënë Komunitetit Evropian, nëse Shqipëria do të ofronte koncesione më të mira në masë të ndjeshme kundrejt këtyre vendeve.

### Deklaratë e përbashkët për nenin 28 të Marrëveshjes (MSA neni 41)

1. Komuniteti deklaron gatishmërinë e tij të shqyrtojë në Këshillin e Stabilizim Asociimit, çështjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në kumulimin diagonal të rregullave të origjinës menjëherë sa të krijohen kushtet ekonomike dhe tregtare ashtu si edhe kushtet që garantojnë kumulimin diagonal.

2. Duke pasur parasysh këtë, Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të krijuar zonat e tregtisë së lirë veçanërisht me vendet e tjera që mbulohen nga Procesi i Stabilizim Asociimit i Bashkimit Europian.

### Deklaratë e përbashkët për nenin 39 të Marrëveshjes (MSA neni 73)

Palët bien dakord që për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare përfshin veçanërisht të drejtën e autorit, duke përfshirë në mënyrë të veçantë të drejtën e autorit për programet kompjuterike dhe të drejtat shoqëruese, të drejtat e bazave të të dhënave, patentat, dizenjot industriale, markat tregtare dhe markat e shërbimeve, topografinë e treguesve gjeografikë të rretheve të integruar, duke përfshirë titullin e origjinës, ashtu si edhe mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme siç përmendet në nenin 10a të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe mbrojtjen e informacionit të padeklaruar mbi ekspertizën.

Deklaratë e përbashkët për nenin 49 të Marrëveshjes (MSA neni 126)

1. Për qëllimet e interpretimit dhe zbatimit praktik të Marrëveshjes, Palët bien dakord që rastet tepër urgjente të përmendura në nenin 49 të Marrëveshjes janë ato raste kur ka shkelje materiale të Marrëveshjes nga njëra nga të dy Palët. Shkelje materiale të Marrëveshjes përbën:

   – mosnjohja e Marrëveshjes e pasanksionuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare

   – shkelje e elementëve thelbësore të Marrëveshjes të parashikuara në nenin 1

2. Palët bien dakord që "masat e duhura" të përmendura në nenin 49 janë masat e marra në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Nëse një Palë merr një masë në një rast tepër urgjent sipas nenit 49, Pala tjetër mund të përdorë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Deklaratë e Përbashkët

Për Principatën e Andorës në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

1. Produktet me origjinë në Principatën e Andorës të përfshira në Kapitujt nga 25 deri në 29 të Sistemit të Harmonizuar, pranohen nga Shqipëria si produkte origjinuese në Komunitet brenda objektit të kësaj Marrëvesheje.

2. Protokolli 4 zbatohet *mutatis mutandis* për qëllimin e përcaktimit të statusit origjinues të produkteve të lartpërmendura.

Deklaratë e Përbashkët

Për Principatën e San Marinos në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

1. Produktet me origjinë në Republikën e San Marinos, pranohen nga Shqipëria si produkte origjinuese në Komunitet brenda objektit të kësaj Marrëvesheje.

2. Protokolli 4 zbatohet *mutatis mutandis* për qëllimin e përcaktimit të statusit origjinues të produkteve të lartpërmendura.

Deklaratë e Komunitetit

Duke marrë në konsideratë masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti Europian për vendet pjesëmarrëse ose ato të lidhura me Procesin e Stabilizim Asociimit, duke përfshirë Shqipërinë, në bazë të Rregullores (EC) Nr. 2007/2000, Komuniteti Europian deklaron se:

– në zbatim të nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen ato masa unilaterale të tregtisë autonome të cilat janë më të favorshme si shtesë e koncesioneve tregtare kontraktuale të ofruara nga Komuniteti në këtë Marrëveshje për aq kohë sa Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 2007/2000 e ndryshuar zbatohet;

– veçanërisht për produktet e mbuluara nga Kapitulli 7 dhe 8 i Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilën Tarifa e Përbashkët Doganore parashikon aplikimin e tarifave doganore *ad valorem* dhe një tarifë doganore specifike, ky reduktim zbatohet gjithashtu në tarifat doganore specifike në derogim të dispozitës përkatëse të nenit 14.1 të kësaj Marrëveshjeje.

---